



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 20 dhe 25 qershor 2018
2. Seancë dëgjimore me grupet e interesit në lidhje me disa propozime për ligjin “Për statusin e jetimit”.

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Flamur Golemi, Adelina Rista, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Nuri Belba, Floida Kërpaçi dhe Nora Malaj.

Mungojnë:

Edlira Bode, Vangjel Tavo, Halim Kosova, Grida Shqima, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Bardh Spahia

Të ftuar:

Ilir Çumani – përfaqësues i Institutit Kombëtar të Integritetit të Jetimëve Shqiptarë
Muazeze Kanushi – përfaqësuese e Institutit Kombëtar të Integritetit të Jetimëve Shqiptarë

Justina Aliaj - përfaqësuese e Institutit Kombëtar të Integritetit të Jetimëve Shqiptarë
Liljana Luani – përfaqësues i Misionit në Mbështetje të Fëmijëve Jetim të Gjakmarrjes
Gjin Marku - përfaqësues i Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar
Skënder Velu - përfaqësues i Unionit për Zhvillim dhe Integritet të Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro Drom”

Lulzim Resuli - President i Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë
Endrit Reka - koordinator i Grupit Joformal në Ndihmë të Jetimeve të Shqipërisë
Mehdi Gurra (Saimir Rusheku) - përfaqësues i Fondacionit ALSAR.
Elton Peka - përfaqësues i Komitetit të Bashkuar Kuvajtian
Ermal Cela - përfaqësues i fondacionit “Mirënjohja”
Denis Zavalani - drejtori i Real Vizual.
Edmond Sharka – sekretar i Shoqatës Kombëtare të Jetimeve
Ahmet Gjinishi - Koordinator bordi në SHKJSH
Alfred Muharemi - drejtor ekzekutiv i organizatës "E Ardhmja jonë "
Sabail Gjyli - drejtor organizativ organizatës "E Ardhmja jonë "
Erida Bajrami – koordinator e organizatës "E Ardhmja jonë "
Dritan Sakuta - Presidenti i Kongresit Rinor Kombëtar
Ina Verzivolli - specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve në UNICEF
Iva Zajmi - konsulente e UNICEF-it në mbështetje të Grupit Parlamentar “Miq të Fëmijëve”
Ardiana Jaku - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Denada Seferi - drejtoreshë drejtorie në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Lida Leskaj – nëndrejtoreshë e Shërbimit Social Shtetëror

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Në kalendarin e punës së komisionit ka qenë e parashikuar një seancë dëgjimore me grupet e interesit në lidhje me disa propozime për statusin e jetimit. Në këtë dëgjese të sotme unë falënderoj të gjithë pjesëmarrësit që ndodhen këtu, duke filluar nga Instituti Kombëtar i Integritit të Jetimëve Shqiptarë! Me mirëkuptimin tuaj nuk po lexoj të gjithë emrat, por po lexoj institucionet dhe secili do të bëjë vetë prezantimin kur t'i vijë radha.

Shoqata Kombëtare për Gruan dhe Fëmijët, Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë, Fondacioni ALSAR, Misioni për Mbështetjen e Fëmijëve Jetimë të Gjakmarrjes, Instituti për Dinjitetin Njerëzor, Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, Federata e Paqes Universale, Shoqata Kombëtare në Dobi të Gruas Shqiptare, Unioni për Zhvillim dhe Integrit të Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro Drom”, Shoqata kombëtare e policëve të rënë në detyrë “Martirët e Policisë së Shtetit”, organizata “E ardhmja jonë”, ka përfaqësues nga UNICEF-i, nga shoqata e bashkive të Shqipërisë, nga fshati SOS, nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga CRCA-ja, nga Avokati i Popullit dhe nga Ministria e Shëndetësisë, që janë zonja zëvendësministre, Ardiana Jaku, zonja Alida Leskaj dhe zonja Merita Xhafaj.

Meqenëse kemi një pjesëmarrje të rëndësishme falënderoj edhe një herë të ftuarit për pjesëmarrjen e tyre në këtë takim! Kuptohet që dëgjesa ka një synim, që grupet e interesit të shprehen lidhur me propozimin dhe qëndrimin për ligjin “Për statusin e jetimit”.

E para e punës, komisionit i duhet të jetë sa më sintetik në gjetjet që do të dalin nga kjo dëgjese në mënyrë që t'i përkthejë ato brenda të gjitha hapësirave që ka në ndryshime, dhe e dyta, për t'u krijuar hapësirë të gjithëve për të komunikuar. Do t'ju lutesha të ishit shumë sintetik me kohën! Nuk kam asnjë lloj predispozite dhe as dëshirë t'a pres fjalën ndonjërit, por meqenëse kemi një mbledhje informative që na orienton idetë dhe ndryshimet, na duhet të jemi sintetikë. Këtë ftesë jua bëj të gjithëve. Në momentin kur ndonjëri do ta ketë të vështirë të kontrollojë kohën dhe veten, do të jem i detyruar ta ndërpres.

Le të fillojmë pa humbur kohë. Koha në dispozicion është 4 minuta për t'u shprehur, 3 minuta për Këshillin e Europës, 4 minuta i keni ju. Besoj se është një kohë e bollshme.

Fillimisht e nisim me Institutin Kombëtar të Integritit të Jetimëve Shqiptarë, me zotin Ilir Çumani. Janë edhe dy të ftuar të tjerë, zonja Muazeze Kanushi dhe Justina Aliaj.

Të gjithë deputetët kanë një material të përmbledhur për të pasur parasysh, sigurisht që është në vijim të dëgjësës së sotme, prandaj, zoti Çumani, ky material është shpërndarë. Këtë e them për informim për kolegët.

Fjala për ju, zoti Çumani.

Ilir Çumani – Faleminderit!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile,

Pjesëmarrës në këtë dëgjësë,

Nisur nga realiteti dhe situata e përgjithshme jo e mirë sociale dhe ekonomike që po kalon i gjithë komuniteti i fëmijëve jetimë pa kujdes prindëror, me synimin për të përmirësuar statusin social të kësaj kategorie, i propozojmë Kuvendit të Shqipërisë dhe qeverisë shqiptare që të marrë në konsideratë disa sugjerime dhe propozime konkrete nga ana jonë. Siç dihet numri i kategorive të fëmijëve pa kujdes prindëror klasifikohet me kategorinë e fëmijëve jetim biologjikë dhe fëmijëve socialë pa kujdesin prindëror me një prind, me prindërit gjallë, por të pa aftë për të ushtruar të drejtën prindërore, apo atyre që iu është hequr e drejta me vendim të gjykatës.

Kategoria tjetër e këtyre fëmijëve pa kujdesin prindëror është ajo e fëmijëve me prindër të gjallë dhe të divorcuar, apo të emigrantëve që i kanë lënë vetëm këta fëmijë dhe që nuk kujdeset askush për ta. Siç shihet e gjithë situata e këtyre fëmijëve, që në rrethana të ndryshme humbasin familjen dhe kujdesin prindëror, vjen nga rrethana të karakterit social dhe ekonomik të këtyre familjeve që janë në risk, ndaj, për këtë arsye ne paraqesim disa propozime konkrete që kanë të bëjnë me përmirësimin e ligjit aktual “Për statusin e jetimit”, të akteve ligjore dhe nënligjore që janë në funksion të këtij ligji dhe jo vetëm kaq. Për këtë arsye propozojmë:

1. Të bëhen ndryshime të nevojshme thelbësore për në ligjin “Për statusin e jetimit”, që do të thotë se ky ligj duhet të përshtatet me kushtet e realitetit të ri social dhe ekonomik në përshtatje me rrethanat që dikton kohezioni social në përputhje me mundësitë financiare të shtetit shqiptar për të përballuar pa sforco dhe në mënyrë organike koston financiare nga buxheti i shtetit, që buron nga nevoja imediate për ndryshimin e këtij ligji.

2. Ligji për statusin e jetimit duhet të fokusohet qartë dhe prerë te përgjegjësitë dhe kompetencat që ka pushteti lokal, kryeqendësitë, komunat, bashkitë, qarqet, por edhe institucionet qendrore të të gjithë zinxhirit administrativ dhe ekzekutiv që kërkon ligji për zbatimin me efikasitet të plotë të legjislacionit në fuqi.

3. Ky ligj duhet të zgjerojë optikën e mbrojtjes dhe të përkrahjes sociale jo vetëm për një kategori të caktuar të fëmijëve pa kujdesin prindëror, siç është rasti i fëmijëve me të dy prindërit e vdekur, fëmijë me një prind gjallë, me një prind të vdekur, apo fëmijë që i kanë

prindërit gjallë, por nuk kanë mundësi juridike për të ushtruar detyrën prindërore ose kjo e drejtë iu është hequr me vendim të formës së prerë nga gjykatat tona.

Në harkun kohor të 28 viteve të tranzicionit të zgjatur 1990-2018 konstatojmë se nuk ka asnjë studim në shkallë vendi të një numri real të fëmijëve pa kujdesin prindëror në vend. Kjo ka sjellë një anomali të theksuar për trajtimin real të kësaj shtrese shoqërore, si dhe ka krijuar një ngërç institucional për zbatimin me sukses të politikave të mbrojtjes dhe ndihmës sociale nga institucionet e shtetit shqiptar.

Për këtë arsye propozojmë që të ndërmerren nisma nga ana e qeverise shqiptare që përmes INSTAT-it, në bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes Sociale dhe Shëndetësisë, Shërbimit Social Shtetëror, Zyra Rajonale e këtyre shërbimeve dhe të gjithë zinxhirit administrativ dhe ekzekutiv të këtyre shërbimeve, të fillohet një studim i mirëfilltë në shkallë kombëtare për të evidentuar saktësisht numrin real të fëmijëve pa kujdesin prindëror kudo që ata ndodhen, në fshatra, komuna, bashki dhe qarqe.

Të evidentohen kushtet dhe rrethanat ekonomiko-sociale në të cilat ato ndodhen në fshatra, komuna, bashki dhe qarqe. Kjo do të bëjë të mundur klasifikimin e kategorive të caktuara të fëmijëve pa kujdesin prindëror, ku më pas të mund të ndërhyhet me emergjencë dhe efikasitet përmes një plan-veprimi të mirëstudiuar me politikat e ndërhyrjes, mbrojtjes dhe mbështetjes sociale, fuqizimit të familjeve në risk dhe parandalimit të fenomenit të braktisjes së fëmijëve përmes këtyre programeve.

5. Të rishikohet dhe të bëhet një rivlerësim i plotë dhe real i të gjitha kapaciteteve dhe standardeve të shërbimeve që ofrohen në qendrat e ndryshme rezidenciale të përkujdesit të fëmijëve jetimë, si në ato shtetërore dhe ato private, OJF, të identifikohen dhe vlerësohen me objektivitet këto standarde me synimin e vetëm për t'i përafëruar këto shërbime me modelet e vendeve të BE-së.

6. Të realizohet një reformë e plotë dhe reale e të gjitha kapaciteteve humane të personelit dhe stafeve multidisiplinare, që ofrojnë këto shërbime, si dhe të rekrutohen në këto shërbime njerëz të aftë dhe profesionistë larg ndikimeve dhe emërimeve partiake. Thjesht nevojiten njerëz me integritet të lartë human dhe profesionist të cilësisë së lartë, gjithashtu ata duhet të kenë pasion për punën që bëjnë.

7. Qendrat sociale ku ofrohen shërbime, si Shtëpia e të Moshuarve në Tiranë dhe dy qendrat rezidenciale ku trajtohen fëmijët pa kujdesin prindëror, shtëpia e foshnjës “Ana” dhe “Rozafa” në Sauk, Tiranë, më fëmijë nga mosha 0-3 vjeç dhe shtëpia e fëmijës shkollore “Zyber Allulli” në Tiranë, nga mosha 7- 16 vjeç përfundimisht duhet të kalojë në administrimin e pushtetit lokal, pra të bashkisë së Tiranës. Këto qendra duhet të dalin nga juridiksioni i shërbimit social shtetëror, ashtu siç kanë dalë të gjitha qendrat në mbarë vendin, pasi, siç ka

rezultuar në gjithë këto vite, jo vetëm që ato kanë qenë mjaft problematike në keqadministrim, shpeshherë, dhe me abuzim nga institucionet e prapë, nga të cilat ato varen, por edhe në pritshmërinë e rezultateve për standardet e kërkuara, lënë shumë për të dëshiruar. Shpeshherë këto qendra janë keqpërdorur dhe keqpërdoren politikisht dhe administrativisht nga Shërbimi Social Shtetëror. Për këtë arsye propozojmë që këto qendra ta kalojnë menjëherë dhe pa u vonuar në administrimin e Bashkisë së Tiranës. Patjetër që kjo do të ketë një profil tjetër dhe performancë të mirë në administrimin më transparencë dhe më rezultativ për qëllimin që ato janë ngritur dhe funksionojnë.

Kjo është arsyeja pse pushteti lokal është më pranë realitetit, e prek atë dhe e di situatën dhe është më pranë personave me nevojë. Duke vlerësuar faktin që qendrat rezidenciale ku ofrohen shërbime për fëmijët pa kujdesin prindëror konsiderohen si qendra të rëndësishme të veçantë, për shkak të natyrës specifike që kanë, propozojmë që në këto qendra të disloketohet kujdesi parësor shëndetësor 24 orë në 24 me një mjek për çdo qendër, i cili do të jetë në gatishmëri të plotë për çdo rast emergjent në ndihmë të shëndetit të fëmijëve, pasi, deri tani, mjekë për këto institucione nuk ka pasur dhe nuk ka. Kjo është e papranueshme.

8. Në qendrat joqeveritare ofrohen shërbime mjaft të mira që flasin për standarde bashkëkohore. Atje ka personel mjaft të kualifikuar që kujdesen dhe shërbejnë për fëmijët pa kujdes prindëror. Mirëpo edhe këto qendra kanë problemet e tyre që kanë të bëjnë me mungesën e vëmendjes jo aq dhe si duhet të institucioneve shtetërore për t'i nxitur dhe përkrahur ata.

Për shembull, si mundet që shteti të mos bëhet mbështetës dhe kontribues për të mbuluar disa shpenzime jetike, siç janë shpenzimet e energjisë elektrike?

Si mundet që shteti të taksojë ndihmat humanitare, që donatorë të ndryshëm investojnë bujarisht për fëmijët pa kujdes prindëror?

Si mundet që shteti ynë, në këto qendra ku ofrohen shërbime falas për jetimët, të aplikojë taksën e TVSH-së për çdo shërbim që blihet dhe ofrohet për ta?

A nuk është e padrejtë që shteti të heqë dorë nga çdo detyrim që ka të bëjë me fëmijët pa kujdes prindëror dhe të bëhet pengesë, duke rritur barrën fiskale për elementet më bazike të jetës së tyre të përditshme? Kjo bie në kundërshtim me parimet më elementare të humanizmit.

Një shtet i fortë dhe solid është ai që tregohet i përgjegjshëm dhe kontribues për mbështetjen dhe fuqizimin e statusit social të shtresave në nevojë. Për këtë nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë ekuivok.

10. Te ligji “Për statusin e jetimit” duhet të konsiderohet fakti që fëmijët jetimë, pasi dalin nga këto qendra rezidenciale të shkollimit të detyrueshëm 9-vjeçar, nëse nuk kanë mundur të rikthehen në familjet e tyre biologjike apo të kenë gjetur një tjetër familje alternative përmes procedurave të birësimit, të sistemohen në mënyrë tranzitore në një qendër rezidenciale. Këto

qendra quhen qendra polivalente rinore. Këta të rinj, të strehohen në këto qendra, të arsimohen, të ushqehen, të vishen dhe të përfitojnë të gjitha shërbimet e nevojshme, deri në përfundimin e shkollës së mesme.

Deri tani, këto qendra shtetërore polivalente nuk kanë ekzistuar në vendin tonë, përveç rastit të qendrave rinore private, të cilat vetëfinancohen dhe administrohen me shumë sukses nga fshati SOS. Pra, të mendohet nga qeveria ngritja e 4-5 qendrave shtetërore polivalente rinore, për të rinjtë pa kujdes prindëror, që dalin nga shtëpitë e fëmijëve, ku t'u sigurohet gjithë shërbimi i nevojshëm, deri në përfundim të shkollës së mesme. Këto qendra duhet të synojnë dhe të realizojnë qëllimin e mbështetjes dhe përgatitjes së këtyre të rinjve për vetëveprim dhe pavarësi, pasi dalin në këto qendra, përmes punësimit, strehimit të tyre me programe të avancuara dhe preferenciale nga shteti shqiptar.

11. Të ndërhyhet nga qeveria shqiptare për Bashkinë e Shkodrës, që të veprojë sa më shpejt në evakuimin e të rinjve jetimë, të cilët prej vitesh jetojnë në godinat e vjetra të konvikteve, në kushte tepër mizerabël. Ato godina janë krijuar si mjedise geto. Të rrezikuar për shëndetin, ata duhet të sistemohen në godinën e re, që është ndërtuar enkas për këta të rinj.

Bashkia e Shkodrës, prej kohësh dhe pa asnjë arsye, po e vonon këtë proces, edhe pse godina e re e rikonstruktuar, me të gjitha kushtet bashkëkohore, ka kohë që është gati për t'u banuar nga këta të rinj. Ka një hezitim pa kuptim të kryetares së Bashkisë së Shkodrës, zonjës Voltana Ademi. Kjo e fundit, mendoj të thërritet urgjentisht nga Komisioni për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në një dëgjese tjetër publike nga deputetët dhe grupet e interesit, për të dhënë shpjegimet e nevojshme se përse nuk po veprohet nga Bashkia e Shkodrës për strehimin e këtyre të rinjve në mjediset e godinës së re, e destinuar enkas për të rinjtë jetimë dhe familjet e tyre.

12. Propozojmë që ndihma ekonomike për kategorinë e jetimëve dhe të fëmijëve pa kujdes prindëror, minimalisht, të ketë vlerën 10 mijë lekë të rinj në muaj, një vlerë modeste dhe mjaft e arsyeshme, gati sa gjysma e asaj që ka propozuar Avokati i Popullit 2 vjet më parë në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo vlerë jo vetëm që përputhet me nivelin e vendeve të rajonit, si: Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova e të tjerë, të cilat kanë vite që e aplikojnë për kategorinë e fëmijëve jetimë dhe të atyre pa kujdes prindëror, si ndihmë ekonomike me vlerë 80-120 euro në muaj, por në radhë të parë, ka të bëjë me dinjitetin e njeriut, me të drejta e tij, që burojnë nga Konventa Ndërkombëtare e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, për të bërë një jetë të drejtë dhe me dinjitet.

Këtu askush nuk duhet të mbyllë sytë dhe të bëjë sikur, aq më tepër vendi ynë, ka arritur disa standarde dhe synon negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

14. Të ndërhyhet menjëherë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” dhe të korrigjohet neni 18, pika 1, ku thuhet: “Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së Jetimëve Shqiptarë, sipas mundësive financiare të planifikuara për këtë qëllim.”

Po sjell në vëmendje, të nderuar deputetë, faktin se ky ligj ka që në vitin 2004 që adreson në mënyrë të gabuar dhe në shkelje të hapur të ligjit një fond vjetor prej 16 milionë lekësh të vjetër nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, për një shoqatë që, e theksoj, nuk ekziston. Me vendim gjykate ajo është suprimuar dhe është rithemeluar një shoqatë e re me emër tjetër.

OJF-ja, me emërtesën Shoqata e Jetimëve Shqiptarë, është organizatë që nuk eksiton prej 15 vjetësh, pasi në vitin 2004 ajo është suprimuar dhe është çregjistruar si subjekt juridik nga Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë, për arsye të ndryshme, mes së cilave edhe për faktin se kjo shoqatë ka qenë problematike. Disa drejtues të kësaj shoqate kanë qenë me rekorde kriminale dhe janë dënuar nga gjykatat tona penale për abuzim, vjedhje, mashtrime dhe abuzime me fëmijët jetimë, si dhe nga elementë kriminalë pedofilë, të dalë nga kjo organizatë.

Këtu kemi materiale audiovizuale të 8 programeve investigative për këtë shoqatë. Kemi edhe vendimet e gjykatave penale, që do t’jua vëmë në dispozicion.

Për pakujdesi, për inerci, apo mungesë të vëmendjes nga ligjvënësi, shuma vjetore prej 16 milionë lekësh të vjetër, i delegohet në mënyrë të gabuar një tjetër organizatë, me emërtesë gati të ngjashme me atë të parën, Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë. Edhe kjo, bazuar në dokumentacionin që disponojmë, është një shoqatë nuk ofron shërbime, nuk ka asnjë standard, as kapacitete, si të them, disiplinore dhe është e palicencuar.

Petrit Vasili – Ilir, të të bëjë një pyetje?

Ilir Çumani – Po.

Petrit Vasili – Që të jem edhe korrekt me auditorin.

E para e punës, që të jemi të qartë, ne përcaktuam një kohë. Mbi këtë kohë nuk del dot as Ilir Çumani, as Petrit Vasili.

Ilir Çumani – E mbarova, edhe pak kam.

Petrit Vasili – Më fal, ta mbaroj!

Meqenëse jeni miqtë tanë, edhe ne kemi rregullat tona. Pavarësisht kësaj, materiali është shpërndarë dhe paraprakisht të gjithë deputetët e kanë. Ju, nga materiali prej 12-13 faqesh, duhet të zgjidhni (ju e kryet tashmë) 4-5 momentet kryesore, që duhet të merrnin vëmendjen kryesore të deputetëve, pasi secili nga deputetët e ka dhe e studion materialin e detajuar dhe nuk ka nevojë t’u rilexohet fjalë për fjalë, se nuk është normale dhe nuk është në respekt të punës që bëjnë deputetët. Në rast të kundërt...

Ilir Çumani – Nëse ju e gjykoni se mund të...

Petrit Vasili – Mos ma ndërprit fjalën!

Në rast se do të kishit ndonjë gjë, që ju mund ta improvizonit tani, plotësisht normale, do ta thoshit të gjithën, por ne e kemi materialin në duar.

Ilir Çumani – Dakord.

Petrit Vasili – Ne po ju ndjekim fjalë për fjalë dhe ju po lexoni po të njëjtin material. Kjo nuk shkon. Ju keni edhe mundësi të tjera, që këtë material të plotë, sikurse e keni këtu, përveçse në formë integrale, mund ta bëni publik ku të doni, nuk ju ndalon njeri. Ne duam të dëgjojmë 4-5 momente që vërtet do të jenë momente kyçe në projektligji përkatës.

Për sa u takon çështjeve dhe raporteve të tjera që keni, në spektrin e përfaqësimit me shoqatat, ne jemi pak të interesuar t’i dëgjojmë, po jua them sinqerisht. Neve na duhet problematika, na duhet të vijmë në Kuvend dhe të kemi një status të ri të jetimëve, shumë më të plotë, që u përgjigjet të gjitha ekzigjencave që ka më poshtë gjithë trajtimi i kësaj kategorie shumë delikate, shumë vulnerable dhe, në mënyrë të veçantë, me elemente shumë dramatike për ndërtimin e jetës së tyre familjare. Këtu të qëndrojmë. Kjo është ajo që ne dhe opinioni publik ka interes ta zgjidhë.

Për çështje të tjera, që nuk i takojnë kësaj tavoline, qeveria ka instrumentet e saj që i diferencon, atje ju mund t’i ngrini. Edhe po të na i ngrini ne këto çështje, nuk ju ndihmojmë dot, me mirëkuptim po jua them.

Ilir Çumani – Po, zoti kryetar.

Unë e respektoj mendimin tuaj, por duke mos evidentuar problematikat ne nuk i zgjidhim dot problemet. Ne kemi 20 e kusur vjet që kemi problematika shumë të thella, që vijnë pikërisht nga keqmenaxhimi, nga abuzimet, nga shpërdorimet, nga “të bëjmë sikur ndihmojmë” dhe nuk po zgjidhim problemet.

Për sa i përket problemit të fundit që relatova, për fondin që delegon qeveria, është një gjë që ka interes publik dhe në qoftë se paratë e taksapaguesit shqiptarë adresohen në mënyrë të gabuar, në kundërshtim me ligjin, nuk e di, nëse ju e gjykoni se është një gjë normale, është gjykimi juaj.

Gjithsesi, unë po e mbyll fjalën time dhe po lë hapësirë edhe për të tjerët.

Petrit Vasili – Ilir, bëre mirë që e mbylle, se në qoftë se gjykojmë... Nuk jam unë objekti i debatit, absolutisht. Unë po them çfarë kemi interes të dëgjojmë ne.

Në rast se ka shpërdorime me fondet, Ilir, ke plotësisht të drejtën tënde t’i denoncosh dhe unë jam dakord me ty, por nuk është vendi këtu për t’i denoncuar, jo se nuk duam ne t’i dëgjojmë, por është problem që t’i thua se ka vite që nuk zgjidhet...

Ilir Çumani - Janë gjëra me interes publik.

Petrit Vasili -...Le të shkojnë dhe t'i adresojnë aty ku duhet të zgjidhen. Nëse ka shpërdorime, ka instrumente qeveritare dhe juridike që i zgjidhin. Edhe po të duam ne, kujt...? Falë propozimeve tuaja, ne duam të bëhet një ligj dhe një status sa më i plotë, që t'i evitojë këto gjëra. Pra, historitë e së shkuarës, mësohen nga e shkuara dhe kthehen në një praktikë të mirë legislative, që nuk lë vend dhe hapësira për të tjerat.

Megjithatë, faleminderit!

Ndonjë shtesë tjetër?

Nga kolegët ka ndonjë problem tjetër?

Në rregull.

Faleminderit, zoti Çumani!

Vazhdojmë me të ftuarit e radhës.

Nga “Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë”, zoti Lulzim Resuli e ka fjalën.

Lulzim Resuli – Së pari, më lejoni t’ju përshëndes dhe t’ju falënderoj shumë që jemi sot pjesë e kësaj dëgjese!

Pa dyshim që në këto 20 e disa vite tranzicion jetimët ndodhen vërtet në problematika të ndryshme, që ne jemi përpjekur herë pas here t’i anonçojmë dhe njëkohësisht të kërkojmë ndihmesën tuaj dhe të të gjithë faktorëve të tjerë.

Dua t’ju falënderoj për zemërsisht, zoti Kryetar, njëkohësisht edhe gjithë grupin e deputetëve!

Më lejoni, që në emër të shoqatës, të falënderoj gjithë grupin joformal të shoqatave në ndihmë të jetimëve të Shqipërisë, të cilët sot janë së bashku me mua!

Njëkohësisht, dua të falënderoj edhe të rinjtë e fshatit SOS, me të cilët jemi përpjekur të bëhemi një grup, për të çuar përpara kauzën e jetimëve, të cilët kanë kaq vite që i mbajnë thuajse peng dhe nuk kemi ende asnjë moment real për t’u ardhur në ndihmë dhe për të qenë koherent dhe pranë tyre.

Ne kemi parë problematika të ndryshme për të cilat sot unë dua që, së pari, statusin e jetimit ta ndryshoj pikërisht nga target-grupi.

Nëse target-grupi është i kufizuar, detyrimisht që shërbimin do ta marrë një grup i kufizuar personash dhe një grup tjetër denigrohet. Kështu, dua të them që përveç fëmijëve, të cilëve u mungojnë të dy prindërit, fëmijë të cilët braktisen dhe janë pjesë e rezidencave të shërbimit social shtetëror, njëkohësisht edhe ata të cilët i kanë humbur prindërit nga vendimet definitive gjyqësore, gjatë të cilave nuk arrijnë të kenë kujdesin e tyre, të kenë statusin e jetimit. Por ne kemi thënë gjithmonë se statusin e jetimit duhet ta përfitojnë edhe të gjithë ata fëmijë

që janë me një prind, që do të thotë të ofrojmë një gamë shërbimesh edhe për atë të cilët e kanë humbur njërin prej prindërve.

Nga ana tjetër, dëshirojmë që, me anë të statusit të ri, të rriten shërbimet që do t'u vijnë në ndihmë jetimëve. Gjatë gjithë kësaj periudhe kemi parë problematika të ndryshme në qendrat e shërbimit social shtetëror dhe nuk e dimë se çfarë ndodh edhe në qendrat e shërbimit social privat.

Ne dëshirojmë t'ju sugjerojmë që në partneritet me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrinë e Shëndetësisë, së bashku me Shërbimin Social dhe përfaqësues të Shoqatës Kombëtare të Jetimëve të Shqipërisë, duke i përfshirë të gjithë grupet e interesit së bashku, të arrijmë të ndërtojmë një punë të tillë gjatë së cilës këto qendra të rezultojnë si një shoqëri aksionere me grup bordi brenda. Në qoftë se do të ketë një grup bordi brenda, do të kemi disa benefite përfituese.

Së pari, do të kemi transparencë të përgjithshme të sjelljes dhe të mirëfunksionimit të stafit brenda këtyre qendrave rezidenciale.

Së dyti, do të kemi një transparencë të fondeve, të cilat vijnë për t'u ardhur në ndihmë jetimëve të këtyre rezidencave.

Së treti, bordi do të luajë edhe një funksion shumë të rëndësishëm, sepse ai mund të jetë përthithës i donatorëve të tjerë, që mirëqenia e këtyre fëmijëve nga dita në ditë të rritet.

Së katërti, Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë në draftin e saj, i cili është përgatitur me shumë shpejtësi gjatë këtyre ditëve, për shkak se jemi njoftuar të premten, ka si pikë reference mbështetjen e arsimimit të fëmijëve jetimë të të gjitha kategorive.

Ne shohim sot se fëmijët janë të denigruar për shkak se u bënë kaq vjet që, kur vjen pjesa e subvencionimit për tekstet shkollore, fëmijët jetimë me status përfshihen për t'u subvencionuar, por duhet thënë se fëmijët jetimë me status i përfitojnë këto benefite për shkak se janë pjesë, janë jetimë të shtetit.

Çfarë do të ndodhë me këta fëmijë, të cilët në rezidencën, në shtëpitë e tyre dhe nuk e marrin subvencionin e teksteve shkollore dhe i detyrojnë nënat e veja kryefamiljare t'i fusin detyrimisht në punë të zeza, në punë të rëndonmta dhe t'i heqin nga shkolla?

Prandaj ne kërkojmë të vihet menjëherë si pikë, që para shtatorit mundësisht, subvencionimi i teksteve shkollore të jetë për të gjitha kategoritë e jetimëve.

Duhet t'u jepet përparësi jetimëve për pjesën e bursave në shkollat profesionale dhe më pas të gjithë studentët, të cilët arrijnë të ndjekin shkollën e lartë të kenë bursa shkolle të veçanta, të cilat rakordohen midis ministrisë përkatëse me pjesën e pushtetit lokal, pikërisht me këshillat bashkiake.

Nga ana tjetër, ju kërkojmë që shteti shqiptar për jetimët që kanë humbur të dy prindërit dhe për jetimët, të cilët janë banorë ose pjesë e qendrave të shërbimit social shtetëror, të kenë edhe një stimul financiar ekstra, që t'i stimulojë ata dhe të mbulojë edhe disa nevoja të rëndësishme për veshmbathje dhe nevoja të tjera personale, të cilat nuk ka arsye t'i përmendim këtu.

Së fundmi, në pjesën e arsimit, një prej pikave tona shumë të rëndësishme është që shteti të mbulojë 100% të gjithë studentët ekselentë, duke u dhënë mundësinë dhe përparësinë të vazhdojnë pjesën e studimeve ekstra, pra ato që u përkasin gradave shkencore dhe njëkohësisht edhe trajnimeve të ndryshme kualifikuese brenda dhe jashtë vendit, ku i gjithë subvencioni financiar të jetë i shtetit.

Duke qenë se ne jemi një grup që gjithmonë shpreh të drejtat e njeriut, duhet të kuptojmë se një prej personave që duhet të përfitojë dhe të jetë pjesë e prekshme e statusit të jetimit, duhet të jenë të vejat kryefamiljare, në rastet kur bashkëshorti i tyre para se të ndërronte jetë ka qenë në një marrëdhënie pune, zonja le të përzgjedhë nëse do të marrë ndihmën ekonomike 10 mijë lekë apo do të marrë pensionin e bashkëshortit.

Ne sugjerojmë se, në qoftë se kjo zonjë rrit 3 fëmijë, atëherë të marrë pensionin e bashkëshortit dhe nga pjesa e kujdestarisë të marrë një subvencion 10 mijë lekë të reja.

Dua të them se Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë është një shoqatë që shtrihet në 36 bashki dhe ne dëshirojmë që së bashku me të gjithë grupet e interesit, të formojmë pjesën joformale, por që do të jemi në shërbim të jetimëve dhe të gjithë së bashku të marrim pjesë në komisionet e birësimit ku të themi fjalën tonë për të birësuar të gjithë ata fëmijë për të krijuar familje për këta fëmijë jetimë, të jemi të mirinformuar se ku po shkojnë fëmijët shqiptarë në familjet shqiptare të cilat mund t'i rrisin dhe të kenë të gjithë aksesin për t'u dhënë një mirërritje dhe nga ana tjetër edhe për familjet që janë jashtë vendit tonë.

Nga ana tjetër, të kemi pjesëtarët tanë në të gjitha komisionet e çështjeve sociale në pushtetin lokal për të ndikuar në strehimin, në arsimimin dhe në ndihëm ekonomike që duhet t'u jepet me përparësi këtyre familjeve.

Duke ju falënderuar dhe duke shpresuar shumë që brenda pak ditëve ne do të sjellim draftin tonë, për shkak të efektit të kohës, ju uroj punë të mbara!

Petrit Vasili – Faleminderit, zoti Resuli!

Faleminderit edhe Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë!

Materiali është depozituar, sepse ka pasur një material edhe për këtë dhe të gjithë kolegët deputetë e kanë në shqyrtim.

Urdhëroni!

Justina Aliaj – Faleminderit për ftesën!

Në fakt, unë do të flas diçka krejt tjetër, gjithmonë në lidhje me fëmijët, aty ku mendoj se duhet të punojmë. E kam fjalën për anën shpirtërore dhe ndihmën konkrete që u jepet fëmijëve jetimë. Për mua është tepër e vyer e do të doja të thosha se nëse mungon shpirti, më duket se edhe ana teknike nuk zgjidhet, edhe çështjet e financave nuk zgjidhen. Për mua, në qoftë se shpirti është në lojë gjithçka zgjidhet.

Unë do të kisha mbetur e pakryer sot me këtë ftesë që me keni bërë, në qoftë se nuk them se kam ardhur me një propozim konkret për anën shpirtërore sociale të fëmijëve. Fëmijët e braktisur janë atje dhe ne nëse nuk i ushqejmë shpirtërisht bëjmë dy herë mëkat.

Unë mendoj se duhen sensibilizuar komunat apo kryepjeqësitë apo bashkitë për të marrë në dorë një propozim që nuk është imi, që më ka frymëzuar shumë, ka qenë para disa muajsh propozim apo sugjerim i Presidentit tonë, zotit Ilir Meta, për të marrë fëmijët nëpër shtëpi. Kjo nuk është kaq e thjeshtë, por e kam menduar dhe them se jo vetëm nëpër shtëpi, po duhet ta kemi detyrim ndoshta një herë në tre muaj gjithsecila familje të marrë një fëmijë në shtëpi. Ai fëmijë do të jetë shumë më i butë në shpirt, ndoshta edhe ai fëmija i familjes që mund të jetë më keq me mësimë do të sensibilizohet prej këtij fëmije që ndoshta është më mirë me mësimë. Sikur 20% të shpirtit tonë të japim, sikur një herë në 3 muaj, e sigurt është se fëmijët nuk keqtrajtohen dhe fëmijët ushqehen dhe kanë një përkujdesje, nuk mënjanoen e nuk neglizhohen.

Unë vetëm këtë kisha për të thënë.

Petrit Vasili – Ju faleminderit shumë për praninë e për sugjerimin!

Absolutisht që është një sugjerim, pse jo edhe propozim, në kuadër të rishikimit të statusit e të gjithçkaje që ne kemi përpara. Patjetër që do të duhet të rishikohen të gjithë instrumentet, për ta kthyer në një lloj... Do të ishte një detyrim i vërtetë, një detyrim që do të bëhej jo nga halli, por në mënyrë të ndjerë. Besoj se edhe ju e ndani me mua këtë mendim, që çdo gjë në të cilën nuk investohet shpirtërisht, por bëhet në mënyrë të ftohtë, nganjëherë investon të kundërtën, në vend që të investojë të mirën.

Ne duam ta përkthejmë si apel në të gjithë shoqërinë shqiptare, që të për të qenë më zemërdhembshur, për të kuptuar edhe faktin se nuk është gjithçka thjesht mbijetesë biologjike, vetëm t'u japim ushqim, t'i veshim e t'i mbathim. Ky është një detyrim bazik, të cilin besoj se në kohën e sotme nuk duhet as ta përmendim. Pjesa tjetër, ajo që është, le të themi, hendeku i madh, i cili kërkon punë pa fund për t'u mbushur, është pikërisht ana shpirtërore. Drama e kësaj kategorie është pikërisht ana shpirtërore, pasi mekanizmat e tjerë, me të mirat e me të këqijat e tyre, kanë dhënë disa përgjigje për sa i takon asaj që unë e quaj mbijetesë bazike. Në lidhje me këtë, jo vetëm që ka shumë punë për të bërë, ndaj çdo lloj propozimi do të jetë jo vetëm i mirëpritur, por të gjithëve ne këtu na vë në një ndjeshmëri tjetër, shumë më të fortë se më parë.

Ju faleminderit edhe një herë, zonja Aliaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Prezantohuni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prezantohuni një herë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, zonja ... nuk është se nuk e keni zërin e dëgjueshëm. Këtu çdo gjë mbahet shënim. se po të jetë se nuk mbahet shënim e bëjmë në kafene këtë punë, kështu që prandaj e kam merak unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hajde, se do të lëvizim të gjithë, ngaqë kush mbaron do t'ia lërë vendin të tjerëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muazeze Kanushi – Pyetjen e kam për zëvendësministrin e punëve sociale, meqenëse është e pranishme në këtë tryezë.

Edhe nga diskutimi i dy parafolësve, këtu doli se ka shumë shoqata që merren me çështjen e jetimëve e të fëmijëve në nevojë. A ka në Ministrinë e Punës dhe Çështjes Sociale një departament, i cili është trajnues, monitorues, kontrolluesi të gjitha këtyre shoqatave? Njëkohësisht, a shkon produkti i ofruar nga donacione të ndryshme, te baza, te jetimët? Sepse, kështu mund të flitet goxha, por unë kam përshtypjen se këto janë më shumë retorikë, se sa të shkojnë atje ku duhet, te jetimët.

Dhe, meqë mund të përgjigjet pak më vonë apo më shpejt, si të dëshironi ju...

Petrit Vasili – Këtë e zgjidh unë. E zgjidh unë se si e drejtoj.

Pyetje tjetër keni, zonjë?

Muazeze Kanushi – Jo, nuk kam pyetje tjetër. kam për të thënë diçka, në rast se më lejoni.

Petrit Vasili – Shumë përmbledhtas.

Muazeze Kanushi – Po, përmbledhtas.

Për mua tre janë problemet kryesore të jetimëve. Përveç fjalës së zonjës Pustina, që është strehimi, punësimi dhe edukimi, aty futet edhe ana shpirtërore.

Do ta marr nga edukimi, meqë këtë problem e njoh më mirë, për shkak të përvojës së gjatë që kam në arsim. Natyrisht, edukimi fillon herët, por numri i këtyre fëmijëve që janë në nevojë dhe jetimë, po rritet dita-ditës. Madje pyeta, dhe gjithmonë kam qenë në korrent, se krahasuar edhe me periudhën e para '90-ës, është më shumë se sa dyfishi. Jo tek fëmijët biologjikë, që janë aty, por tek fëmijët me probleme sociale.

Atëherë, si i bëhet me problemet e edukimit të tyre? A janë të thithur në qendrat rezidenciale shtetërore apo private? Unë mendoj se jo. Kjo sepse nuk ka funksionuar bërthama bazë, që është pushteti lokal. Pushteti lokal, ashtu siç është nëpër botë, që shkon dhe e monitoron edukimin e fëmijëve që në familje, dhe në rast se ai keqtrajtohet, e merr nën kujdesin e tij, duke mbajtur qëndrim ndaj prindërve, me ligj, te ne nuk funksionon. Numri është më i vogël nga ç'është realisht në vendin tonë.

Ne ligjet i kemi, dhe i kemi të përparura. Në rast se në Kushtetutat e vendeve të tjera dinjiteti i njeriut është neni 1, edhe ne e kemi, ndonëse është 54 e 59, se duke lexuar për këtë temë, e vura re se e kishim të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës sonë, por gjithsesi e kemi. Edhe statusi i jetimëve është i mirë, se e lexova me kujdes, por a zbatohet? Problemi është tek zbatimi, jo te legjislacioni. Atëherë kush duhet ta bëjë zbatimin? Për mua koordinator dhe ai të cilit i ka rënë barra, është shteti me organizmat e veta.

A do të përgatisim, e këtë e kemi tek edukimi, njerëz të tillë, që të na shquhen, siç ka ndodhur në përvojën botërore, dhe janë jo pak të tillë, duke filluar nga John Lennon, Salvador Dali, Dante Alighieri e të tjerë, apo do të përgatisim Hitlerë? Sepse edhe Hitleri jetim ka qenë.

Në rast se problemet e edukimit ia lëmë spontanitetit, atëherë, në mos shkoftë deri në ekstrem si Hitleri, do të bëhen drogaxhinj, hajdutë e të tjera, që përbëjnë një problem të madh kombëtar. Çështja e jetimëve nuk është problem, por kauzë. Duhet të shndërrohet në kauzë kombëtare për të tëra institucionet të merren me edukimin e që merren me problemet e tjera të çështjeve kombëtare.

Problemi tjetër është strehimi. Ligji është. Banesat sociale, ndër të favorizuarit përfshijnë edhe këtë kategori. Por a zbatohet? Ne, si qytetarë, kemi parë që ka shumë jetimë, të cilët dalin e protestojnë, ngaqë mbeten në rrugë nga prishja e kabanoneve, e shtëpive me kushte jo të mira higjienike, apo në konvikte ku janë futur fshehurazi. Atëherë, a është evidentuar se çfarë bëjnë këta fëmijë, pasi mbushin moshën 18 vjeç?

Problemi tjetër është punësimi. Mbarojnë klasën e nëntë, që është në sistemin e detyrueshëm arsimor. Ç'do të bëhet me këtë kategori? Ndoshta këtu tek edukimi, ashtu si në botë, duhet të ketë këshillues të karrierës, që të fillojë që kur është i vogël dhe të evidentojë shfaqjen e personalitetit të fëmijëve, se në ç'drejtim e ka më tepër predispozitën për të vazhduar. Në rast se mbaron klasën e nëntë, atëherë te punësimi t'u jepet përparësi zanateve. Ka mundësi që, nëpërmjet shkollave profesionale apo kurseve të ndryshme, që të bëhen gati për tregun e punës, e jo të marrin udhët e të dalin me atë tabelën: "Më jep ndonjë lek, se jam jetim", sepse kjo na dhemb të tërëve.

Unë nuk jam nostalgjike për atë kohë që shkoi. Ajo ka pasur të mira e të këqija. Jetimët i damkoste. Ne tani nuk e kemi konceptin e kopilit e të tjera, siç ka qenë në atë kohë, por organizimin nuk e kemi në atë shkallë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, në rast se...

Petrit Vasili – Zonja Muazeze kam një gjë për t’ju thënë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Muazeze Kanushi – Jo, unë nuk ofendoj njeri.

Petrit Vasili – Më fal, ju lutem!

Muazeze Kanushi – Në atë kohë ishte ky koncept, tani ka evoluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili- Ju lutem, mos ndërhyini!

Muazeze Kanushi – Në dispozicion të ligjit, do të ngrihen organizma shtetërorë për të zbatuar statusin e fëmijëve jetimë.

Petrit Vasili - Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk mund të ndërhyini ju për procedurë, ndërhyjnë deputetët.

Zonja zëvendësministre, do të ktheni një përgjigje të shkurtër, nëse mundeni?

Adriana Jaku – Faleminderit!

Po e përmbledh,

Petrit Vasili - Si të dëshironi, është në zgjedhjen tuaj, doni të dëgjoni edhe të tjerët dhe të flisni më vonë, të jepni përgjigjen në fund? Dakord.

Kalojmë te shoqata kombëtare “ Për gruan dhe fëmijët”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të flisni të gjithë me radhë.

Zonja Prifti është? U largua. Në rregull.

Nga shoqata kombëtare “ Jetimi në fokusin tonë” është zoti Hysen Dosti? Nuk është.

Nga fondacioni “ALSAR”, zoti Medi Gura?

Misioni “ Në mbështetje të fëmijëve jetimë në gjakmarrje”, zonja Liliana Luani.

Liliana Luani- Përshëndetje!

Që prej 15 vjetësh përpiqem të jap sado pak kontributin tim me fëmijët me problematikë gjakmarrjen edhe si aktiviste me familjet e tyre. Lidhur me nismat që duhet të

merren nga Kuvendi i Shqipërisë për përmirësimin e ligjit “ Për statusin e jetimit”, si edhe masat që duhet të marrë qeveria për përmirësimin e kushteve sociale, mendoj se këtu duhet të trajtohet me shumë kujdes edhe problematika e fëmijëve, që janë jetimë familjet e të cilëve janë të përfshirë në konflikte gjakmarrjeje që janë jetimë. Këta fëmijë kanë problematikë të dyfishtë krahasuar me fëmijët jetimë. Nuk dua asnjëherë të anashkaloj problematikën e fëmijëve jetimë, pa prindër, unë jam vetë prind dhe e di se çfarë do të thotë fëmijë, por fëmijët në gjakmarrje, ku familjet e tyre ose prindërit e tyre i kanë humbur për shkak të gjakmarrjes, duhet të shikohen me një sy tejet social.

Vetëm në qarkun e Shkodrës janë afro 20 fëmijë me të cilët punoj në gjakmarrje dhe që janë jetimë. Për këta fëmijë nuk kam parë të ketë ndonjë interesim për të punuar me ta, si fëmijë jetimë, aq më tepër si fëmijë në gjakmarrje. Ka fëmijë jetimë që kanë humbur të dy prindërit, babai i është vrarë për gjakmarrje, ndërsa nëna ka vrarë veten me varje, sepse nuk ka mundur të përballojë jetën. Këta fëmijë jetojnë me gjyshërit. Kam dy fëmijë në Mazrek në situatë të tillë që i vizitoj shumë shpesh. Siç e kam thënë dhe herë të tjera më bie shpeshherë telefoni dhe më kërkojnë bukë. Këta fëmijë jetojnë në kushte tejet të vështira ekonomike, ku u mungon edhe buka. Ka fëmijë siç janë në Koplik, 6 fëmijë ku babai kohët e fundit i ka vrarë mamanë. Pastaj familja e nënës ka kaluar në konflikt, në gjakmarrje dhe fëmijët jetojnë në kushte tejet të vështira. I ati tashmë është në burg, e ëma i ka vdekur dhe jetojnë me një xhaxha të sëmurë psikik. Ende nuk shikoj se ka vënë dorë njeri për këta fëmijë, që t'i çojë në institucionet përkatëse.

Ka fëmijë të tjerë në Dukagjin ku familja është në konflikte shumë të ashpra gjakmarrjeje, janë 3 fëmijë, nëna e tyre ka vrarë për shkak të gjakmarrjes me marrë hak, i ati është krejtësisht i papërgjegjshëm dhe me këta fëmijë nuk punon askush.

Ka fëmijë në Bardhaj, në Shkodër që jetojnë brenda me lopën si në kohën e Migjenit. Me një nënë tejet të sëmurë dhe me fëmijë me problematika sociale, shëndetësore e të tjerë.

I solla këto shembuj në vëmendjen tuaj, të nderuar deputetë dhe përfaqësues të shoqërisë civile për ta ngritur fort zërin tim para jush, që të vihet dorë dhe të merren masa sa nuk është tepër vonë për këta fëmijë. Nëse fëmijët jetimë mund të rrezikojnë të jenë kontingjent krimi, këta fëmijë janë kontingjent krimi nëse nuk punohet shpejt me ta. Unë përpiqem me të gjithë forcën e shpirtit të punoj me këta fëmijë, por duhet të bëhet shumë më tepër edhe shteti ka filluar të kthejë sytë. Vëmendjen nga kjo problematikë, nga gjakmarrja në përgjithësi dhe nga fëmijët në veçanti, por puna edhe për arsimimin e fëmijëve duhet të jetë shumë më e madhe dhe për problemet e tyre sociale duhet të ndërhyjë urgjentisht. Duhet të ndërhyhet te familjet e tyre me projekte punësimi dhe integrimi, duhet të ndërhyhet me politika sociale, duhet patjetër që fëmijët jetimë me problematikë gjakmarrjen të vizitohen,

t'iu krijohet mundësia e vaksinave, pasi kohët e fundit me financimin e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë më është mundësuar një studim në rang kombëtar i problematikës së gjakmarrjes, ku nga Nikaj-Mërturi deri në Durrës, derë më derë dhe shtëpi më shtëpi, kam parë se aty problematika është tejte serioze. Këtë studim ia kam paraqitur shtetit shqiptar dhe shpresoj që edhe sot në këtë mbledhje në këtë komision, në këtë seancë dëgjimore, të dëgjohet zëri im, që te ligji “Për statusin e jetimit” të ketë një hapësirë, një vend edhe për jetimët me problematikë gjakmarrjen.

Ju falënderoj të gjithëve që më dëgjuat!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Liliana për informacionin shumë konkret, për sensibilitetin e jashtëzakonshëm që krijuat edhe për këtë kategori shumë të veçantë me të cilën ju impenjoheni!

Do të doja t'ia jepja fjalën në emër të Komunitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar, zotit Gjin Marku.

Gjin Marku – Ju falënderoj për ftesën!

Për mua është shumë pozitiv fakti që komisionet e Kuvendit, ky komision shumë i nderuar dhe i dobishëm, fton aktorët e shoqërisë civile, faktorët kryesorë në komunitet për projektligjin “Për statusin e jetimit”, i cili për mua është një status i përcaktuar me ligj, por që ndoshta ka ardhur koha të sillen probleme të reja që kanë dalë, si edhe duhet të rishikohet.

Falënderoj edhe zotin Qemani për ekspozenë dhe problemet që nxori!

Zonja Luani paraqiti probleme, të cilat ne i kemi prekur prej 25 vjetësh në terren në lidhje me familjet e përfshira në të gjitha llojet e konflikteve dhe të hasmërive, pasi shoqëria dhe dinamika e saj në territorin shqiptar ka qenë në tranzicion shumë të vështirë. Dua të theksoj, në mbështetje të fjalës së zonjës Luani se fëmijët jetimë të gjakmarrjes kanë një problem shumë më madhor, sepse për shkak të vuajtjes së tyre janë të nxitur në të gjitha drejtimet të bëhen vrasës për të marrë hak dhe gjak.

Në nenin 14 thuhet: “Jetimët trajtohen me përparësi në emigracionin e organizuar nga shteti”. Më duket pak e paqartë se si e organizon emigracionin shteti shqiptar. Mund të thuhet: “Shteti në mbështetje të lëvizjes për emigrim të familjeve me probleme sociale në Shqipëri merr përsipër të ndihmojë dhe t'i rehabilitojë ata brenda dhe jashtë Shqipërisë”. Nuk duhet të marrë përsipër shteti më shumë se sa i takon, me ligjet apo vendimet e qeverisë, veçanërisht në aspekte ku nuk mund ta realizojë këtë gjë.

Nën nenin 67 të ligjit “Për OJF-të” thuhet: “Organizatat jofitimprurëse janë të pavarura. Veprimtaria e organizatave fitimprurëse zhvillohet në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat e shtetit.

Kam shumë vjet që shoh se qeveria dhe shteti implikohen, ndoshta në mënyrë të gabuar, me shoqërinë civile, ndoshta duke dashur të bëjnë edhe protagonizëm para opinionit publik, që më shumë i përket protagonozmit politik. Shoqëria civile duhet t'i ketë larg duart nga shteti dhe të jetë partner i shkëlqyer për të parë të ardhmen e njerëzimit dhe funksionimin e shoqërisë demokratike. Në këtë aspekt, ne kemi luftuar vazhdimisht që shoqëria dhe traditat e saj pozitive, me rregullat dhe zakonet e së shkuarës, të vihet në dispozicion dhe në mbështetje të shtetit të së drejtës. Shoqëria civile është faktori numër 1 përballë shtetit, ashtu siç janë edhe mediet një faktor shumë i rëndësishëm. Në shoqërinë civile përfshihen edhe shumë elemente të tjera të veprimtarisë njerëzore, por organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë sa më bashkëpunuese në aspektin e fondeve dhe të përcaktimit të atij që quhet bashkëpunim monetar. Pse duhet të themi që ka një ose dy organizata jetimësh që marrin fonde nga shteti, kur dhjetë të tjera nuk marrin?! Ne e kemi diskutuar që para 20 vjetëve problemin e fondeve për misionet e pajtimit dhe kemi thënë: "Jo, asnjë fond. Kjo është traditë vullnetare dhe do ta kryejë vullnetarisht punën e saj". Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile duhet të sanksionohet edhe në ligj, sepse kjo agjenci ka një fond të qeverisë shqiptare, ku mund të aplikojnë të gjitha organizatat, ashtu siç e kanë edhe donacionet e Bashkimit European. Pra, shoqëria civile duhet të jetë sa më e pavarur nga fondet e shtetit, sepse, së pari, do të bëhet vegël e qeverisjes, e mirë ose e keqe qoftë ajo, në qoftë se është e mirë, ajo duhet të jetë sa më e shkëputur nga këto shpërblime monetare dhe të thotë: "Të lutem, më bëj oponencën!". Bashkëpunimi më i mirë mes qeverisë dhe parlamentit është të bëjë oponencën në mendimet tona si shoqëri civile, në mënyrë që të dërgojnë ujë në një rrjedhë të përbashkët, që është lumi i shoqërisë, ku të gjithë jemi të përfshirë. Prandaj, unë them që në ligj duhet të përcaktohet që shteti të ketë një fond në mbështetje të jetimëve dhe t'ua shpërndajë bashkive. Bashkitë duhen të marrin një përgjegjësi shumë të madhe, sepse nuk ka kuptim që bashkitë të mos e dinë se ku janë jetimët, ato i kanë të regjistruara të gjitha familjet në gjendje civile dhe duhet të kenë të paktën një nëpunës, siç ishte në vitin 2000, për konfliktet në fshatra dhe në qytete. Shteti duhet të marrë përsipër atë që i takon, qeveria të jetë e ngarkuar me detyra të posaçme, të përcaktohet fondi për jetimët, të cilin ua shpërndan bashkive dhe këtu mbaron detyra e qeverisjes. AMSHC-ja ka ngritur edhe një këshill kombëtar, të cilin e kam refuzuar që në fillim dhe nuk shkoj atje, sepse shoqëria civile nuk ka nevojë për një këshill kombëtar, ajo është faktor shumë i rëndësishëm dhe shumë i lirë. Ne vijmë këtu me dëshirën për të parë se si funksionon përfaqësuesi i popullit në komisione.

Unë i falënderoj zotin Vasili dhe zonjën Spiropali që vijnë me shumë dëshirë për të diskutuar për këtë çështje, por duhet të jemi të qartë në ndarjen e punëve tona. Nuk duhet ta implikojmë shoqërinë civile, sepse sa më shumë t'i japim liri, aq më shumë do të kemi sukses dhe fryte.

Prej 25 vjetësh ne vetëfinancohemi, nuk financohemi as nga donatorët dhe as nga bizneset. Nëse unë i them në mes të natës një misionari në Nikaj-Mërtur, ai ngrihet dhe shkon, por as nuk jap fonde dhe as gjej fonde, sepse ai e di shumë mirë që ne funksionojmë në bazë të traditës, e cila është shkëlqyer për shqiptarët. Edhe për jetimët kemi një traditë, kemi 3-fshin e familjeve të jetimëve shqiptarë që jetojnë në familje, sepse vetë lidhja e gjakut, morali, humanizmi i shoqërisë shqiptare nuk i lejon që të shkojë në institucionet e shtetit. Në mbështetje të traditës së mirë shqiptare, këtë duhet ta promovojnë mediet, këtë duhet ta promovojmë edhe ne si shoqëri civile dhe këtë duhet ta promovojnë edhe partitë politike në parlament, të zbulojnë vlerat tona kombëtare dhe t'i paraqesim edhe nëpërmjet ligjit.

Më falni, sepse u zgjata shumë, por këtu duhet të fokusohemi të gjithë. Ndoshta sot nuk kemi ardhur shumë të përgatitur, por them se ligjet duhet të përgatitën thellësisht. Bashkëpunimi është kur ne sjellim mendimin, jemi më të saktë, por ligjet duhet të jenë ligje dhe të respektohen. Duhet t'i lëmë liri edhe shoqërisë civile, sepse jo çdo gjë bëhet me ligj në këtë vend, por duhet të ekzistojë edhe liria, edhe aktivizimi vullnetar për të ndihmuar. Shteti i së drejtës është shtet i së drejtës dhe pyetja që ne duhet të bëjmë si shoqëri civile është: a e kemi shtetin e së drejtës, pastaj qeveria ta bëjë punën në kuadër të shtetit të së drejtës?

Edhe një herë, ju kërkoi ndjesë për zgjatjen e fjalës sime!

Faleminderit!

Petrit Vasili- Ju falënderojmë për praninë tuaj, edhe për shkak të problematikës delikate, që ju përballeni për një kohë shumë të gjatë, e cila, në bazën e saj ka elementet zakonore, vlera që ne i kemi konservuar, dhe kemi bërë mirë, sepse, në fund të fundit, na kanë mbrojtur edhe nga tronditjet e ndryshme, me të cilat Shqipëria është përballur. Ky këndvështrim që ju sollët, patjetër që duhet materializuar, sepse kjo, së bashku me propozimin që zonja Aliaj solli, janë hapësira, ku ne duhet të eksplorojmë dhe duhet të vazhdojmë t'i promovojmë fort, sepse janë krijuar për të mbyllur atë që quhet boshllëk shumë i madh shpirtëror. Sa më pranë familjeve të kushrillëkut, të gjakut e të tjerë të jenë jetimët, aq më të lehtë ua bëjnë dhimbjen shpirtërore që ata kanë. Në fund të fundit, të gjithë jemi prindër dhe e dimë shumë mirë që nuk mund të jetë një dhimbje shpirtërore e zgjidhur përfundimisht, por, në qoftë se shoqëria bën çdo gjë që ta zvogëlojë këtë dhimbje dhe ta transformojë në pozitivitet, aq më të lehtë e kanë dhimbjen ata. Këtë duhet të bëjë shoqëria dhe jo ndërhyrje mekanike, që më shumë kanë *show* sesa përmbajtje.

Faleminderit, zoti Marku!

Fjalën e ka zoti Muharemi, drejtor ekzekutiv i organizatës “E ardhmja jonë”.

Alfred Muharemi – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Së pari, ju falënderojmë për ftesën, duke na konsideruar si grup interesi, për të diskutuar dhe për të dhënë propozimet që mendojmë se janë të nevojshme për ndryshimin e statusit të jetimit! Ftesa ishte: “Propozime për ndryshime në statusin e jetimit”. Pra, ne duhet të japim propozimet tona në lidhje me ligjin aktual të statusit të jetimit, i cili është nr. 8153 i datës 31.10.1996. Me thënë të drejtën, pjesa më e madhe këtu nuk është se aludoi ndonjë ndryshim të caktuar, por thjesht kishin vetëm merakun e fondeve, ku i akumulon shteti fondet.

Më vjen keq, unë jam Alfred Muharemi, bankier, kontabilist, i rritur jetim në fshatin “SOS”. Kam marr një frymë nga një organizatë tepër serioze në Shqipëri dhe sot pranë jush përfaqësoj zërin e të gjithë të rinjve jetimë, që realisht e kanë humbur besimin nga përfaqësimi jokorrekt i kategorisë së jetimëve, duke më dhënë dhe mua ndoshta të drejtën për ta përfaqësuar disi.

Dëmi më i madh për 27 vjet nuk janë politikat sociale të vendit tonë, por është lufta e ashpër për interesat personale ndaj organizatave të shoqërisë civile, të cilat e kanë humbur thelbin e kësaj lloji kategorie. Pra, thelbi është vetëm çështje monetare, nuk është më thelbi se si duhet të adresohet dhe ku duhet të zgjidhet problemi i fëmijëve jetimë. Së bashku me të rinjtë jetimë, kemi kërkuar ndihmën e departamentit ligjor të organizatës Liburnetik dhe Kongresit Rinor Kombëtar, me përfaqësi të 100 organizatave rinore në vend për shikimin dhe ndryshimin e statusit të jetimit, të cilin do ta dërgoj me *email* pranë jush pasi të mbarojë kjo seancë dëgjimore, sepse kemi 1 muaj që nga data e premtimit nga zonja Spiropali, që ne do të na jepet mundësia për të qenë në këtë komision. Gjithashtu, kemi krijuar mbështetjen e të gjithë shoqërisë, duke krijuar një rrjet vullnetarësh prej një mijë personash në të gjithë Republikën e Shqipërisë, i cili do të shkojë dhe do të kërkojë mbështetjen e të gjithë shqiptarëve për të krijuar dhe për të firmosur petitionin për ndryshimin ligjit të statusit të jetimit.

Në lidhje me relacionin që kam përgatitur, do të flas vetëm për ndryshimet që ne kemi propozuar. Në draftligjin që propozojmë, neni 2, të ndryshohet mosha ku vendoset taksative, mosha aktuale për kategoritë jetimëve është nga 0-25 vjeç, ne mendojmë se duhet të jetë deri në moshën 30 vjeç. Moshë kjo që pushtetet lokale të marrin përsipër problemin më të madh social, si strehimi, kompetencë kjo e bashkive dhe e komunave, pasi shërbimet sociale janë distributuar në rang lokal dhe jo në rang qendror pjesë kjo e ligjit “Për decentralizimin”, gjë që ligji aktual nuk e ka parashikuar këtë ndryshim eventual. Nuk po paraqes ndryshimet për çdo nen, sepse u thanë nga Shoqatat Kombëtare e Jetimëve dhe nga Instituti.

Në nenin 6 janë bërë ndryshime cilësore, ku janë futur edhe kuotat e veçanta që shteti duhet të japë për jetimët që vazhdojnë arsimin e lartë, pasi çdo vit hasemi me kërkesa nga jetimët dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk i trajton këto raste, pasi nuk ekziston baza ligjore për të trajtuar studentët kandidatë, që konkurrojnë dhe nuk mund të fitojnë këtë të drejtë për vazhdimin e shkollave të larta. Mund t’ju përmend se vetëm 1 ose 2 të rinj jetimë në vit përfitojnë kuota të veçanta për arsimin e lartë pasuniversitar.

Gjithashtu, te neni 10 “Për udhëtimin e jetimëve” është shtuar pika 2: “Pajisja me patentë, si domosdoshmëri nga punëdhënësi, ku i kërkon patentën për çdo drejtim automjeti, si në ligjin “Për policinë e shtetit” dhe në shkollën bazë të policisë, ku kandidati, si femër dhe mashkull, duhet të ketë patentë për drejtim mjeti”. Kjo është diskutuar edhe me sindikatat e Policisë së Shtetit. Ju bëj me dije se një nga kriteret për t’u punësuar apo për të qenë pjesë e Policisë së Shtetit duhet patentë, gjë që realisht i riu jetim e ka të pamundur koston për të bërën patentën, për të qenë pjesë e forcave të rendit.

Në nenin 12 janë parashikuar në ligj edhe tri pika të tjera, për punësimin e jetimëve, si dhe nxitjen e ndërmarrjeve sociale, që edhe me këtë ligj pikënisje është marrë statusi i jetimit. Vendosja në këto ndryshime është një domosdoshmëri për të gjithë aktorët që punojnë me këtë targetgrup, siç janë jetimët, pasi dhe pushteti lokal e ka me përparësi hapjen e këtyre ndërmarrjeve.

Në nenin 15 është shtuar: “Për jetimët me aftësi të kufizuar”, që në ligjin aktual nr. 3153, nuk janë përfshirë fare dhe dhënia në këto ndryshime do të sillte risi më integrale dhe kujdes më të mirë dhe më të veçantë. Prandaj bëhet ky propozim për ndryshim, sepse në praktikë operatorët që punojnë në këtë fushë e kërkojnë me përparësi, pra flas për jetimët me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu, është shtuar diskriminimi dhe dhuna, pasi edhe ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nuk e ka të qartë këtë targetgrup, sidomos në ato raste kur shfaqet hapur diskriminimi dhe mënyra sesi duhet mbrojtur për të drejtën e subjekteve, për dhënien e së drejtës të shkelur nga diskriminimi.

Neni 16 është parashikuar si shtesë e re dhe e domosdoshme për faktin se edhe Kodi Penal parashikon se marrja nën përgjegjësi penale fillon që në moshën 14 vjeç, ku edhe ky targetgrup goditet në vazhdimësi nga krimi, duke kërkuar trajnim më të mirë të fëmijëve dhe të rinjve jetimë në ambientet e paraburgimit dhe vendeve të ruajtura të veprave penale, që vërtet janë privuar nga e drejta prindërore deri te liria. Pra, kemi dy komponente: të privuar nga e drejta prindërore dhe nga liria. Për këtë pikë është konkluduar dhe me Ministrinë e Drejtësisë, bazuar edhe në Kartën Ndërkombëtare për të Drejtat e të Dënuarve, prandaj propozojmë të vendoset për të krijuar lehtësi zbatuese në këto institucione. Më vjen keq, por sot janë qindra

jetimë që janë nëpër institucionet e paraburgimit dhe nuk kanë asnjë lloj mbështetje, pavarësisht nga shoqëria civile, të cilët asistojnë me paketa të ndryshme ushqimore apo veshmbathje.

Neni 17 “Strehimi” në ligjin aktual nr. 3153, bie ndesh, pasi ligji nr. 8030 është shfuqizuar kur tashmë është efektiv ligji nr. 9293 “Për strehimin social me kredi të buta dhe banesa sociale”. Ne propozojmë që për moshat deri në 25 vjeç të jetë falas për vetë faktin se në nenin 4 është vendosur me afate kur duhet të fillojë kjo punë. Ndërsa për moshat mbi 25 vjeç trajtimi bëhet sipas ligjit nr. 9293. Kemi propozuar që jetimët për moshat mbi 30 vjeç të trajtohen me status të motivuar, vetëm për strehimin, pasi tranzicioni i gjatë nuk e ka zbutur këtë plagë për këtë kategori. Shumë studime që janë kryer, pra ky jetim ka dalë nga institucionet shtetërore që në moshën 18 vjeç, shto edhe 23 vjet tranzicion nuk është trajtuar që në moshën 30 vjeç të vendosur në ligjin nr. 9293. Prandaj, duhet vendosur si kategori në emergjencë, duke theksuar strehimin si një akt final për integrimin e jetimëve. Ky është një nga problemet kryesore që neve na shqetëson.

Në projektligjin që ne paraqesim është shtuar pika 7 “Pasaportizimi dhe leja e banimit”, sepse jetimët dalin nga institucionet shtetërore dhe private dhe dëshira e tyre është për t’u përqendruar në zonat më urbane dhe ndeshen me këtë fenomen që në moshë të re. Prandaj duhet vendosur në ligj, sepse edhe në organet se pushtetit vendor thuhet shprehimisht: “Nuk e përmban ligji dhe statusi”, prandaj domosdoshmërisht duhet vendosur. Flas për të rinjë që kërkojnë të vijnë në Tiranë, por nuk kanë mundësi, për shembull, për të marrë paketën e banesës sociale ose të asistentëve, sepse thuhet duhet të shkosh në vendin tënd ku ke pasaportizimin.

Neni 18, ndryshimet u diskutuan nga të gjithë anëtarët.

Në nenin 21 propozojmë të shtohen këto pika, pasi në ligjin aktual nr. 8153 nuk janë shkruar fare detyrat që ka Komisioni i Dhënies së Statusit të Jetimit, por funksionon mbi bazë udhëzimesh. I kemi vënë këto ndryshime, sepse nga praktika e përditshme është vërtetuar se ky komision bën thjesht seleksionimin dokumentesh dhe jep librezën e statusit. Për mendimin tim, këtij grup interesi, pra këtij komisioni, që jep statusin e jetimit, duhet t’i jepen më shumë kompetenca dhe detyrime për mbrojtjen më të mirë të jetimëve, sepse është ai që e pajis me status dhe, duke qenë se është më i pranishëm në politikbërje, ka tagrin e njohjes së situatës së jetimëve, pra i jep një lloj fuqie këtij komponenti.

Këto janë propozimet që ne kemi, të cilat do t’jua dërgojmë edhe me email. Unë dua të them diçka si një njeri, i cili është rritur jetim në fshatin SOS. Unë i jam mirënjohës organizatës, e cila ka qenë si prind për mua, duke më dhënë shembullin e mirëkujdesjes, mirërritjes dhe mirëformimit, pra më ka bërë ky njeri që unë jam sot dhe që përfaqësoj. Kush ka gjak në trup, jo ujë, e di shumë mirë se fjala “jetim” të vret moralisht, por edhe shpirtërisht.

Sot, më shumë se 27 vjet tranzicion dhe demokraci, mund të them se hapat përpara për kategorinë e jetimëve në Shqipëri janë pothuajse zero. Duke veçuar ligjin e fundit, të daljes nga institucionet shtetërore të fëmijëve jetimë, dua t'ju them se për këtë gjë nuk është vetëm politika fajtoare, por jemi edhe ne, organizatat e shoqërisë civile, sepse jemi në një luftë të ashpër me njëri-tjetrin. Unë jam vetë një i ri i rritur jetim, që kam dalë nga këto institucione, jam 27 vjeç dhe jam përballur me shpifje nga më të ndryshmet, por nuk kam çfarë të bëj, sepse e kam për detyrë që të jem pjesë e organizatës. Këto gjëra kanë ndodhur, sepse u është dhënë kompetencë organizatave të shoqërisë civile ose atyre që penetrojnë, të cilët përfaqësohen nga jetimët, kur ligjërisht janë të abandonuar nga jetimët.

Kaq kisha! Më falni nëse ju mora më shumë kohë.

Faleminderit, zoti kryetar!

Petrit Vasili - Faleminderit për prezantimin dhe që ishit shumë korrekt, gjithashtu sepse ndatë me ne një eksperiencë, e cila ndonjë mund ta ketë me të dëgjuar, kurse ju e keni përjetuar nga fillimi deri në fund! Ndoshta dëshmia juaj, besoj edhe e disa kolegëve të tjerë që janë këtu, ka një vlerë të veçantë për përjetimin qoftë në planin pozitiv, qoftë edhe negativ. Struktura në të cilën ti je rritur dhe je formuar është një strukturë pikërisht ashtu siç e përshkruat ju. Unë nuk është se kam ndonjë arsye subjektive për ta thënë këtë, por kam pasur komunikime të drejtpërdrejta me trajnerët atje dhe motivimi i tyre besoj se ishte vlera më e madhe. Edhe si infrastrukturë është shumë më mirë, por pa ata njerëz të motivuar dhe pa ato zonja, të cilat kanë shërbyer në ato shtëpi, besoj se nuk do të ishte ajo strukturë që është sot dhe Alfredi, që është këtu sot, në komisionin parlamentar, nuk do të ishte ky që është sot. I falënderoj edhe njëherë në mënyrë të veçantë! A ka ndërhyrje të tjera?

(Diskutime pa mikrofon.)

Mos u shqetësoni! Unë pyeta se kush e do fjalën nga të ftuarit e tjerë përveç atyre që folën.

A dëshironi ta merrni fjalën? Po, prezantohuni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si fillim do të dëgjojmë të gjithë të ftuarit dhe më pas do të vazhdojmë me të tjerët.

Endrit Reka – Quhem Endrit Reka dhe jam koordinator joformal i grupit të interesit të shoqatave, të cilat merren me çështjet e jetimëve.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit, ju falënderoj që na dhatë mundësinë të dëgjohemi! Ky ligj ka 32 vjet që nuk është prekur dhe po të themi se ka ardhur koha për të bërë ndryshime, thjesht do të mashtronim veten.

Jetimët, natyrisht, meritojnë gjithë të mirat e kësaj bote, por, siç jemi të gjithë të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm, i dimë të gjitha kufizimet që ka shteti shqiptar në plotësimin e këtyre nevojave. Megjithatë, unë i kam ndarë në 5 pika se çfarë presim ne nga ky ligj: së pari, ne kërkojmë një zgjerim të konceptit të amendimit për përkufizimit e statusit të jetimit.

Së dyti, kërkojmë të përcaktohen qartë kuotat për përkrahjen sociale, strehimin, punësimin dhe çdo subvencion që ofron shteti për këtë kategori vulnerabël të jetimëve. Pra, të respektohet parimi i proporcionalitetit. Sa më i madh të jetë grupi vulnerabël, aq më e madhe të jetë edhe sasia që ata do të përfitojnë. Këtu dua të shtoj edhe një propozim: vënien në dispozicion apo përfitimin nga asetet e sekuestruara.

Së treti, kërkojmë që OJF-të të kenë lehtësime në sistemin fiskal dhe nëse është mundur të kenë edhe përjashtime nga këto detyrime, për shembull nga TVSH-ja. Aktualisht ekziston një paqartësi në lidhje me TVSH-në, ku kemi pasur shumë raste që edhe në dogana OJF-të janë përballur me vështirësi në futjen e ndihmave, pasi edhe vetë punonjësit në këto institucione nuk e kanë pasur të qartë trajnimin e këtyre ndihmave. Ndonjëherë ata janë shprehur se duhet paguar doganë e plotë apo tarifë e plotë sikur të ishin kompani private.

Së katërti, kërkojmë që OJF-të, të cilat merren me çështjen e trajtimit të fëmijëve jetimë, të kenë mbështetje institucionale nga institucionet e shtetit, siç është, për shembull, INSTAT-i, pasi për këto shoqata, unë jam në dijeni se janë 17, ka edhe publikime në dhënien e bursave. Pra, me ndihmën e institucioneve shtetërore do të kishim një pasqyrë më të qartë të numrit të jetimëve, shpërndarjes së tyre, moshës dhe të gjitha hollësirave të tjera përkatëse.

Së pesti, duhet të ruhen strukturat përkatëse organizative të subjektit publik dhe privat, të OJQ-ve, të cilat merren me çështjet e jetimëve. Natyrisht, nevojitet një bashkërendim më i madh i këtyre subjekteve, në mënyrë që edhe produkti të jetë sa më i qartë. Dua të theksoj faktin se në 17 emra të OJQ-ve (unë i kam te kjo tabela, që besoj se e keni edhe ju, bëra një përlllogaritje në kohën që po flisnin kolegët e tjerë) shpërndahen rreth 38 mijë e 900 bursa çdo muaj në shumën prej 729 mijë eurosh vetëm nga 17 OJF.

Pra, përveç aspektit shtetëror, edhe vullneti, dëshira e shoqërisë civile apo individëve është shumë e madhe. Megjithatë, është me interes dhe duhet që shteti të jetë rregullatori në gjithë këtë organizim të punëve të OJF-ve. Kjo do të arrihet nëpërmjet ligjit që po diskutojmë.

Megjithatë, propozimet tona përkatëse do t'i dërgojmë me shkrim pranë komisionit, për shkak se edhe koha ishte shumë e shkurtër.

Faleminderit!

Petrit Vasili - Faleminderit juve, instituti për dinjitetin njerëzor!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Fjalën e ka zoti Skender.

Skënder Veliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zotërinj deputetë!

E nderuar zonja zëvendës ministre,

Unë përfaqësoj minoritetin rom, por në programin tonë ne bashkëpunojmë me minoritetin egjiptian. Kategoritë që ne përfaqësojmë siç dihet nga të gjithë, janë në gjendje shumë të vështirë, por kategoria e jetimëve është një kategori që asnjëherë nuk ka përfituar, pavarësisht se janë jetimë. Falënderoj në mënyrë të veçantë Institutin që me programin e tij do ta përfshijë edhe këtë komunitet për ta integruar, por vështirësitë janë shumë të mëdha. Të gjitha kategoritë që përmendën kolegët, dhe nuk është nevoja t'i përsëris, i kemi brenda si ata që janë braktisur, si ata me një prindër dhe si ata me dy prindër, të cilët për arsye të ndryshme i kanë lënë fëmijët. Ne jemi përballur me këto vështirësi me anë të projekteve dhe kemi bërë një rregullator brenda. Shpesh i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (edhe zonja Nora që ka qenë zëvendësministre na ka përkrahur), dhe në kuotat që kemi përfituar u kemi dhënë përparësi atyre fëmijëve, që të jenë të barabartë në këtë shoqëri.

Meqenëse jemi edhe në momentin e përmirësimit të statusit, do të dëshiroja, në emër të gjithë minoritetit rom dhe atij egjiptian, që të shikohet kjo kategori që është përbuzur, dhe, më njëfarë mënyre, ato vetvetiu diskriminohen. Pra, duke mos qenë pjesë e kontributeve të shoqërisë, ata dalin fare jashtë kësaj shoqërie dhe, pa kontributin tonë, them se do të lihen në harresë dhe mund të jenë faktor i krimeve të ndryshëm dhe jashtë shoqërisë së emancipuar.

Duke ju falënderuar edhe një herë, kërkoj që në këtë rishikim të statusit të shikohet me përparësi edhe kategoria e fëmijëve jetim, që të përfitojë si e gjithë shoqëria në tërësi.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, Skender!

Prezantohuni, ju lutem.

Dritan Sakuta – Përshëndetje të gjithëve, unë vi këtu si përfaqësues i organizatës Liburnetik dhe departamentit të këshillit ligjor Liberlow dhe i Kongresit Rinor Kombëtar. Unë dua të them që kemi 2 muaj që punojmë me organizatën e Kongresit Rinor Kombëtar dhe me ekspertë ligjorë të departamentit Liberlow për të hartuar një propozim për projektligjin e ri, sepse ligji i vjetër, siç u diskutua, ka shumë mangësi. Kjo ndërhyrje është vetëm për të kërkuar edhe një mundësi tjetër, pra dëgjese tjetër, që ne të kemi mundësi ta dërgojmë, sepse e kishim planifikuar që të punonim edhe pak më tepër, por meqë ndodhi kjo dëgjese...

Petrit Vasili – Dëgjesa është bërë për ta vënë në lëvizje procesin dhe jo për ta mbyllur, pra e hapëm që t'i japim dimensionin e interesimit maksimal dhe të vënies në lëvizje të çdo gjëje. Pra, çdo propozim është i mirëpritur dhe ka kohën e tij. Nuk kemi ngut dhe nuk do vendosim data fikse për sjelljen e materialit. Interesi ynë është që të mblidhen sa më shumë

sugjerime, në mënyrë që grupi i punës të ketë të gjitha materialet që janë sjellë, prandaj mos keni asnjë stres për këtë çështje.

Dritan Sakuta – Faleminderit, kjo ndërhyrje ishte thjesht për të plotësuar kolegun tim, Alfredin, për këtë gjë.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Fjalën e ka zoti Zavalani!

Denis Avalani – Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Denis Zavalani dhe përfaqësoj fondacionin “Real Vizual”, i cili është degë e një fondacioni në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që merret kryesisht me arsimin dhe formimin profesional, specifikisht në seancat *online* të tij. Disa nga kolegët shprehën një listë dëshirash, por pa u fokusuar qartë se si mund t’i zgjidhim këto. Nuk është hera e parë që ne mbledhemi, por nëpërmjet Shoqatës Kombëtare të Jetimëve kemi bërë edhe takime të tjera, të përfaqësuar nga zoti Indrit Reka, i cili përfaqësoi më përpara grupimin joformal të organizatave që merren me fëmijët jetimë.

Shoqata e Kombëtare e Jetimëve ka të reregjistruar rreth 12000 anëtarë. Këtu kam regjistrin e Tiranës me 2500 anëtarë, që rishikohet çdo vit, por kemi edhe organizata të tjera, si shoqata “Alsar”, shoqata e “Katarit” e të tjera, të cilat kanë me nga 8000, me nga 6000 dhe me nga 3000 jetimë. Këtë grupim organizatash është një punë që ne e kemi filluar rreth një vit më përpara, duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin për të gjetur zgjidhje konkrete për problemet e jetimëve. Këtu dëgjova se zonja përfaqëson 20 fëmijë jetim. Me gjithë legjitimitetin që përcakton kjo gjë, dëgjova se nuk janë financuar nga shteti, por zonja tha që është financuar nga OSHE-ja, pra është një gjë e mirë dhe nuk jam i mendimit që duhet kufizuar ndihma e shtetit, por, përkundrazi, duhet shtuar transparenca dhe mbështetja, sepse, në fund të fundit, nuk u shtohet organizatave, por grupeve në nevojë. Prandaj do t’i lutesha grupit të ministrisë përkatëse, që ka marrë përsipër që të bëjë ndryshimet e duhura, ta konsiderojë edhe këtë grupim, i cili mban rreth 20000 fëmijë jetimë me pensione mujore, që vijnë nga organizatat dhe shtetet e huaja.

Një faktor shumë i rëndësishëm është edhe formimi i tyre. Shumë nga organizatat ofrojnë kurse të trajnimit dhe formimit profesional, këtu dal edhe te fusha ime, për t’u krijuar lehtësi këtyre grupeve nëpërmjet shkollave të arsimit të mesëm, pra t’u jepet mundësia që ta rikuperojnë arsimin edhe në një moment të dytë, sepse ndoshta rrethanat e jetës në një moment të caktuar i kanë përjashtuar nga vijueshmëria e ndjekjes së studimeve, të krijohet mundësia që nëpërmjet shkollave specifike, siç është në Tiranë shkolla “Kristoforidhi”, e cila është me kohë të pjesshme, pse jo të ketë edhe një sistem korrespondence, t’u japim atyre dijen, armën më të fortë.

Me shumë nga këto organizata ne kemi konverguar në pikën që duhet të shtojmë mundësitë tona për t'ju krijuar atyre kushtet që të formohen për sa i përket teknologjisë së informacionit (kjo është fusha ime), por edhe gjuhëve të huaja, në mënyrë që t'i përgatisim për një treg pune sa më dinamik.

Nëse ne do të ulemi bashkarisht me grupin e punës, besoj se do të sjellim zgjidhje konkrete për përmirësimin e këtij grupimi. Për të tjerat folën kolegët. Alfredi meriton komplimentet e mia për atë që përfaqëson, sepse kjo grupmoshë ka vërtetë nevojë për modele suksesi, tek të cilat edhe ata të besojnë. Është përhapur ideja se asnjë nga institucionet nuk interesohet për këta fëmijë, ndërkohë ju solla në vëmendjen tuaj që rreth 20 mijë prej tyre marrin pensione mujore, mijëra pako me ushqime çdo muaj, bursa studimi dhe bursa për konvikte. Këtu ka shkolla të caktuara, të cilat vënë në dispozicion bursa për fëmijët, ka shkolla private dhe kopshte ku këta nxënës nuk paguajnë. Ndoshta ka mungesë informacioni, por këtu ka aktorë që veprojnë çdo ditë dhe ju qan shpirti çdo ditë për këta fëmijë, pavarësisht se qajnë në errësirë dhe jo para komisioneve.

Ju ftoj të integroni në këtë ligj edhe pjesë që prekin ligjin e sponsorizimeve ose të përgjegjësisë sociale. Besoj se shumë nga qendrat e formimit do të ishin shumë bashkëpunuese nëse ne, në nivel republike, do të kishim subvencione, qoftë për qendrat e formimit profesional, ato të shtetit, por edhe ato private, qoftë edhe qendrat e kurseve të gjuhëve të huaja nëpërmjet përgjegjësisë sociale me një farë lehtësie fiskale. Ose, nëse do të llogariteshin te ligji i sponsorizimeve, ne do të krijonim disa vatra ku këta fëmijë mund të studiojnë.

Faleminderit për vëmendjen!

Petrit Vasili – Faleminderit, Denis!

Liljana Luani – Sa për sqarim, unë nuk jam përfaqësuese e 20 fëmijëve jetimë në gjakmarrje në Shkodër. Unë jam Liljana Luani, një mësuese vullnetare, që prej 15 vjetësh punoj vullnetarisht me fëmijët në gjakmarrje.

Asnjë prej organizatave që janë këtu nuk është marrë asnjëherë me 20 fëmijët, krejtësisht jetimë, në gjakmarrje në Shkodër. Sot kam ardhur këtu për të ngritur zërin për ata fëmijë.

Jam shumë dakord me propozimin e zotit Ilir, që të bëhet një studim kombëtar për këta fëmijë, pa vënë në regjistra 5 më shumë apo 5 më pak. Të bëhet një studim real. Nëse studimi është real, dikush do të kishte ardhur në Shkodër tek ata fëmijë jetim, që nuk kanë as nënë e as baba. Asnjë prej këtyre organizatave nuk ka qenë asnjëherë. Unë e njoh shumë mirë punën e tyre.

Unë përfaqësoj Liljana Luanin, asnjë organizatë, as ata 20 fëmijë, dhe kërkoj që ata 20 fëmijë në Shkodër dhe shumë e shumë të tjerë, që janë në gjakmarrje dhe jetimë, të kenë

vëmendjen e organizatave dhe të shtetit, sepse vëmendjen e Liljana Luanit e kanë që prej 15 vjetëve, por unë jam thjesht një vullnetare.

Petrit Vasili – Faleminderit!

(Ndërhyre pa mikrofon)

Urdhëroni zonja Zajmi, përfaqësuese e UNICEF-it.

Iva Zajmi – Jam këtu për të përfaqësuar UNICEF-in. Jam këshilltare pranë grupit “Miq të Fëmijëve”, i mbështetur nga UNICEF-i. Dy gjëra doja të shtoja për temën e sotme.

Së pari, në nenin nr. 5 ka disa referenca për moshën, të cilat janë poshtë minimumit ligjor. Flitet për moshën 14 vjeç dhe 17 vjeç, kur fëmijët duhet të mbahen në institucion. Fëmijët deri në moshën 18 vjeç janë të mitur. Kjo do të thotë që nxjerrja e tyre jashtë institucioneve apo jashtë kujdesit nën këtë moshë i vë ata në një pozitë dyfish vulnerabël.

Së dyti, supozimi edhe i këtij statusi, e di që nuk është çështje e tij, është që persona të tillë trajtohen nëpër institucione, ndërkohë që mendoj se duhet bërë ajo që është më e mirë për fëmijët, pra deinstitutionalizimi. Jo se shteti shqiptar nuk harxhon fonde për këtë kategori, jam e sigurt që harxhon, por zgjidhja më e qëndrueshme do të ishte orientimi i fondeve atje ku është më e mira.

Deinstitutionalizim do të thotë që të mos i mbledhësh të gjithë fëmijët që kanë të njëjtin hall apo problem me disa edukatore, që disa e bëjnë me pasion, kurse disa vetëm se paguhet për atë punë, por të gjendet një mjedis më i ngrohtë shpirtëror për ta. Në disa raste mund të jetë gjetja e një familjeje me afërsi gjaku, që të mbështet edhe financiarisht për atë që bën, por mund të ketë edhe familje, që identifikohen nga institucionet përkatëse si të denja në komunitet për ta bërë këtë. Madje, afërsia fizike nuk është kusht. Sot, në botë ka adaptime në distancë, pra, fëmijët mund të qëndrojnë në një qendër, por familje të caktuara, me vullnetin e tyre, vendosin t’i mbështesin për shkollimin apo për ecurinë e tyre në jetë.

Kështu që, mendoj se jemi vonë për këto forma.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Zajmi!

Po, zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Shumë faleminderit që ishit sot këtu!

Jam shumë e lumtur, që, një muaj pas seancës që ne bëmë në Kuvendin e Shqipërisë me ju, shumë fëmijë jetimë, por edhe me njerëz të papërfaqësuar nëpër organizata, që punojnë dhe kanë dëshirë të kontribuojnë për këtë kauzë jemi sot në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë për ta hapur dhe jo për ta mbyllur këtë temë kaq të rëndësishme për shoqërinë tonë.

Kjo është dëgjesa e parë që ne bëjmë. Ju falenderoj për propozimet që sollët, veçanërisht ata që sollën propozime konkrete për ndryshime në nene në Statusin e Jetimit!

E para dhe më e rëndësishmja, është e nevojshme ta themi, ka nevojë urgjente për përmirësime në Statusin e Jetimit. Ka gati 30 vjet që nuk është vënë dorë në mënyrë thelbësore për të ndryshuar këtë ligj, prandaj besoj se na takon neve ta marrim këtë përgjegjësi për ta çuar përpara dhe për të bërë ndryshime aty ku duhen.

E dyta, është e nevojshme të shikohet mundësia e ndryshimit të ligjit për OJQ-të. Nga problematika që del këtu, por edhe nga ajo që diskutohet në tërësi, nuk ekziston problemi i mungesës së fondeve, jo vetëm nga qeveria, por edhe nga donatorë të tjerë, por mungesa e një kanalizimi të mirë të fondeve aty ku duhet, pra, i përfitojnë apo nuk i përfitojnë fëmijët jetimë fondet që vijnë edhe nga donatorë të tjerë.

E kemi diskutuar së bashku edhe në seancën që zhvilluam në Ditën Ndërkombëtare të Jetimëve se ka një sasi shpesh të frikshme të fondeve që shkojnë për jetimët, të cilat ata nuk i ndjejnë.

Nuk ka arsye pse një 18-vjeçar, një fëmijë jetim, të rrijë dhe të flejë poshtë urave apo të zërë hapësira në konvikt dhe pastaj të përzihet, kur ai e ka të pamundur që të sigurojë një strehim. Sigurisht, ligji i ri për strehimin social e parashikon, pa diskutim, dhe e zgjidh këtë problem në rast se zbatohet ashtu siç duhet. Por ligji nuk ka hyrë ende në fuqi dhe unë e nxis Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përfaqësuesit e së cilës i kemi sot këtu, të hartojë aktet nënligjore, në mënyrë që ligji të hyjë në fuqi dhe të jetë sa më shpejt i zbatueshëm, sepse e parashikon. Pastaj na takon neve të monitorojmë nëse po u jepen ose jo shtëpi, strehim social, fëmijëve jetimë, siç e parashikon ky ligj i ri, që, në opinionin tim, është shumë i mirë për këtë kategori dhe shumë kategori të tjera: edhe për romët dhe egjiptianët, edhe për fëmijët e të rënëve në detyrë e të tjerë.

Unë dua të falënderoj posaçërisht edhe Alfredin, në fakt, për studimin, si dhe Këshillin Rinor, me të cilin di sekeni bashkëpunuar dhe keni bërë një punë shumë diligjente në nxjerrjen e neneve, ku ka nevojë për ndërhyrje dhe ndryshime; ndoshta edhe shoqatat e tjera, por nuk i kanë pasqyruar.

Do t'ju lutesha sot që ta sillnit zyrtarisht me shkrim, të merrni kohën e duhur, pasi, siç e thamë, kjo është dëgjesa e parë, do të ketë edhe të tjera. Pra, ne do të mundohemi të bëjmë edhe një dëgjese më të madhe me përfaqësuesit e Komisionit të Ligjeve apo deputetë të tjerë, të interesuar, në mënyrë që ne t'i përcjellim pastaj tek institucionet e tjera.

Çështja e përfaqësimit është shumë e rëndësishme, pasi, në rast se ju që jeni, në fakt, persona të rritur pa kujdesin prindëror, ia keni dalë dhe jeni shembuj për të organizuar të tjerë,

kjo është fuqia më e madhe e presionit pozitiv që ju mund të bëni mbi parlamentin dhe mbi qeverinë për të bërë ndryshimet e duhura dhe të kanalizohen aty ku duhen.

Më vjen keq ta them që kemi pasur kaq pak vëmendje, flas të paktën në nivel parlamentar, për këtë dëgjese, çka u duk edhe sot nga prezenca e medieve: kamerat ishin këtu, ishin tre, dëgjuan, morën dy fjalime nga pesë minuta, dhe shkuan të pasqyrojnë sherrin në komisionet e tjera parlamentare. Kjo tregon nivelin e ulët të ndërgjegjes lidhur me këtë çështje apo edhe me çështje të tjera, që janë çështje të njerëzve. Është e panevojshme që mediet të rrinë dhe të pasqyrojnë çdo sherr parlamentar në çdo komision: “Filani i tha këtij, pastaj ai u përgjigj. I tha për kryetarin, kurse ai u përgjigj për kryetarin e tij”, ndërkohë që duhet të pasqyrojë çështje të tilla dhe të rrisë ndërgjegjësimin. Edhe dëgjesa e sotme shërben pikërisht për këtë gjë, sepse sa më shumë zëra të fortë të jemi për çështje të tilla, besoj se aq më shumë vëmendje do të marrë dhe aq më shumë përgjigje do të jepen nga autoritetet.

Ju falënderoj edhe një herë për zemërsisht, si dhe gjëj rastin të falënderoj edhe zonjën Justina Aliaj që ishte këtu! Që një kënaqësi e madhe t’ju kishim!

Faleminderit!

Justina Aliaj – Kënaqësia ishte imja, gjithashtu!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Spiropali!

Fjalën e kanë kërkuar zoti Çumani dhe zoti Alfred.

Ilir Çumani – Ju falënderoj, zonja Spiropali!

Petrit Vasili – Ju them seriozisht shumë shkurt.

Ilir Çumani – Dua të sjell në vëmendjen e deputetëve të pranishëm këtu vetëm faktin se pesë vjet më parë është bërë një raport i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Integritimit të Jetimëve Shqiptarë, përmes të cilit u soll një sinoptikë shumë e gjerë, konkrete dhe reale e gjendjes së jetimëve në Shqipëri. Kjo është një problematikë e pasqyruar edhe në një rezolutë drejtuar sërish Kuvendit të Shqipërisë, e firmosur nga 100 personalitete të jetës publike dhe shoqërore, lidhur me gjendjen skandaloze të jetimëve në Shqipëri, të abuzimeve të organizatave joqeveritare apo edhe të atyre që shesin moral këtu në këtë tryezë.

Prandaj unë do të dëshiroja, zoti kryetar, që t’i merrni në konsideratë, sepse janë të depozituara në Kuvendin e Shqipërisë dhe do t’ju ndihmojnë për ligjin e ri të statusit të jetimit.

Unë nuk kam ardhur këtu të deklaroj, se edhe unë jam rritur jetim në Shtëpinë e Fëmijës që dy muajsh, t’i bie gjoksit dhe të tregoj se çfarë suksesesh kam pasur në jetën time. Por unë jam këtu për një kauzë, për të mbrojtur fëmijët jetimë nga abuzuesit e veshur me imazhin e rremë.

(Zoti Çumani e vazhdon fjalën e tij pa mikrofon.)

Është shqetësim i madh.

Petrit Vasili – Patjetër.

Zoti Çumani, shumë faleminderit për informacionin!

Ilir Çumani – Kjo situatë është e papranueshme!

Petrit Vasili – Më falni, më falni!

Zoti Çumani, unë kam një detyrim këtu, edhe institucional, që ky komision të mbetet institucional dhe i ekuilibruar brenda hapësirave që ka.

Informacioni dhe gjërat e shkruara mbeten, ndërsa fjalët i merr era.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që, përderisa këtë informacion...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, por kini durim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, Ilir, unë këtu nuk jam Avokat i Popullit, as këto zonjat apo zotërinjtë e tjerë. Këta bëhen pjesë e ndershmërisë suaj dhe po administrojnë informacionin, ku e përgatisin për ata që duan ose jo që t'ju dëgjojnë juve, ne e përmbledhim dhe ua nisim institucioneve përkatëse. Për këtë gjë e bëjmë këtë gjë. Pra, me një fjalë, bëhemi pjesë e problemit, kuptohet, duke qenë racionalë në këtë gjë, dhe biem edhe një herë fort në ndjeshmërinë e institucioneve, të cilat mund të jenë treguar edhe indiferente dhe të shurdhët, që problemi ka këtë ose atë formë.

Ne nuk marrim përsipër në asnjë rast të bëjmë gjykimin përfundimtar të çështjes, pasi nuk kemi atribut këtë.

Ilir Çumani – Ne do të dëshironim...

Petrit Vasili – Ato institucione që kanë atributin ta bëjnë verifikimin e çështjes, edhe për problemin që kanë, të vërtetësisë së tyre, ne i stresojmë fort që ta bëjnë.

Ilir Çumani – Ne do të dëshironim, zoti kryetar...

Petrit Vasili – Nuk i ngatërrojmë rolet e njëri-tjetrit.

Ilir Çumani – ...që politika të qëndrojë sa më larg manipulimit të organizatave joqeveritare, që i përdorin për koperturë politike.

Petrit Vasili – Ilir, këtu nuk ka...

Ilir Çumani – Kjo është shumë e rëndësishme.

Petrit Vasili – Ky është vendi më i gabuar ku e ngre këtë problem. Këtu nuk ka...

Ilir Çumani – Jo, nuk po them për këtë situatë ku jemi.

Petrit Vasili – Ne do të japim shembullin e kësaj situate.

Ilir Çumani – Eksperiencia ka treguar që në këta 25 vjet organizatat joqeveritare kanë bashkëpunuar në mënyrë të qëllimtë me politikën për të mbuluar problemet serioze të jetimëve, duke bërë show.

Petrit Vasili –Nuk dua, Ilir, fare...

Ilir Çumani –Të zhvillojnë seanca plenare, të dalin para deputetëve dhe të mos flasin mirë, kjo është e papranueshme!

Petrit Vasili – Ilir, nuk po bëjmë debat bashkë! E ke gabim, nuk jam unë pjesë e debatit!Mos më fut në këto...

Ilir Çumani – Unë nuk kam ardhur këtu t'i bie gjoksit, se edhe unë jam rritur jetim...

Petrit Vasili – Nuk ka nevojë t'i biesh gjoksit...

Ilir Çumani – ...apo se edhe çfarë historish suksesi kam pasur, se edhe unë kështu e ashtu. Jo, unë jam këtu të mbroj një kauzë!

Petrit Vasili –Kush e vuri në dyshim?

Ilir Çumani – Të gjitha problemet që unë kam ngritur janë reale, ndaj vlerësojini, sepse kjo i shërben përmirësimit.

Petrit Vasili – Më fal pak, me kë po debaton?

(Deputetja Spiropali flet pa mikrofon.)

Ilir, problemi qëndron këtu.

(Deputetja Rista ndërhyr pa mikrofon.)

Më falni, zonja Rista!

Problemi qëndron këtu: ky komision ka për detyrë, të cilën po e bën për mendimin tim shumë mirë, që të jetë i vëmendshëm dhe të dëgjojë të gjithë aktorët në proces, e para.

E dyta, të përcjellë ndjeshmërinë kudo të jetë.

E treta, nuk bëhet fare palë e verifikimit specifik të gjërave specifike, sepse nuk e ka tagrin dhe *atu*-në, por ka këtu, sikurse institucionet e tjera të shtetit shqiptar, të vërë të gjithë kapitalin e tij, në këtë rast politik, sepse është institucion parlamentar dhe i ngritur mbi politikë, në dispozicion të çështjes pa asnjë dallim.Ju nuk i keni parë këtu dhe nuk i dalloni dot për nga mënyra se si e kanë marrë fjalën kolegët se cili është në maxhorancë dhe cili në opozitë. Kjo është qasja jonë për problemin e jetimëve. Çdo tavolinë tjetër, ku ti, Ilir dhe të tjerët do të dalloni që ka një manipulim politik, partiak etj., ngrihuni dhe flisni!

Kjo nuk ekziston këtu. Unë personalisht, nuk e lejoj, kolegët nuk e pranojnë që të ketë një gjë të tillë, kështu që nuk është për t'u prurë në tryezë kjo lloj ndjeshmërie. Këtu jemi që në planin ligjor, bindja jonë është të kemi ligje të mira, të sakta dhe zbatim rigoroz të tyre. Kjo është përgjigja që presin njerëzit. Pjesën manipulative e seleksionon vetë koha dhe institucionet përkatëse, që kanë detyrë të bëjnë këtë punë. Kështu, të qëndrojmë te këto parametra.

Të lutem Alfred shkurt!

Alfred Muharemi – Në radhë të parë, ju falënderojmë përzemërsisht për ftesën, zonja Elisa!

Retorika e vazhdueshme e 27 vjetëve, sulmet e vazhdueshme, kanë që në vitin 2013. Jua them sinqerisht se unë si i ri jetim, e kam ndjerë veten më të mbështetur nga qeveria shqiptare nga viti 2013. Nuk po flas për ndonjë qeveri tjetër, sepse kam qenë i vogël dhe kam qenë në fshatin “SOS” dhe nuk e kam ndjerë shumë.

Nga viti 2013 unë e kam ndjerë veten më të mbështetur nga kjo qeveri. Kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, atë të Mbrojtjes Sociale.

Me retorikën dhe sulmet e vazhdueshme ndaj të rinjve jetimë, që ne përfaqësojmë apo me retorikën dhe sulmet e vazhdueshme ndaj ministres aktuale, nuk mund të ecim dhe nuk mund ta çojnë përpara shoqërinë civile, e cila përfaqëson edhe target-grupin e jetimëve, duke sulmuar 99% të organizatave si joeficiente dhe joefektive, duke sulmuar gjatë gjithë kohës ministren dhe deputetët në një kohë, kur realisht ne na ka mbajtur shteti shqiptar. Ju betohem, se ne na mban shteti shqiptar. Nuk ka as institut apo organizatë që na ka mbajtur dhe na mban ne. Vetëm shteti shqiptar, shoqatat bamirëse, Shoqata Kombëtare e Jetimëve, e cila ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe me shoqata bamirësie kuvajtiane dhe të huaja, të cilat me pensionet e tyre mujore, me kurset mujore dhe trajnimet që na kanë bërë, na kanë sjellë ne këtu ku jemi.

Retorika që vazhdon ende dhe sulmet politike për zonjën ministre, duke e akuzuar se ka bërë këtë apo atë, ka qenë dëmi më i madh, që na është bërë ne.

Petrit Vasili – Alfred, po të jap një këshillë prej babai. Nga mosha që ke, je më i vogël se djali im. Mos u shqetëso për këtë pjesë! Qëndroni në ata parametra! Ec së bashku me shokët e tu profesionalisht në këtë mënyrë! Të jeni të shkathët dhe aplikoni me të gjitha mënyrat për ta fuqizuar shoqatën tuaj! Se si sulmohemi, se si përplasemi ne dhe ministrat, të jeni të bindur se kjo nuk do të ndalet. Në fund fare na duhet, meqë kemi mirëkuptim të plotë me kolegët, të përmirësojmë legjislacionin, sepse ligjet krijojnë hapësira të mëdha. Një ligj i bërë me vrima, bën të rrjedhin aty edhe paratë, edhe interesat, edhe pakënaqësitë e të tjerat. Pra, ta fortifikojmë ligjin në kuptimin më të mirë të fjalës që të jetë shumë solid nga kjo pikëpamje dhe kush do ta manipulojë këtë çështje për interesa politike, do të bëjë as më shumë as më pak, një gjynah te perëndia.

Kjo çështje kërkon solidaritetin e të gjithëve. Këtu jemi të gjithë të bashkuar në këtë frymë. Shpirti dhe fryma e kësaj është pikërisht për këtë. Ju nuk keni dëgjuar sot asnjë ndërhyrje nga kolegët, të asnjë lloj forme, të asnjë ngjyrimi politik. Ka pasur vetëm mbështetje. Ne së bashku me këtë po përpiqemi të japim një standard se si çështje të caktuara kërkojnë edhe opinionin, edhe politikën bashkë.

Ka edhe çështje ku ndahen. Normalisht, do të ndahen. Nuk mund të jemi bashkë për secilën çështje, por këtu po japim shembullin që për probleme të tilla kaq të ndjeshme dhe kaq të dhimbshme, na keni bashkë dhe na keni në mbështetje të plotë. Le të jetë kjo edhe një pasqyrë e mirë për të dalë ata që e shikojnë shtrembër problemin. Prandaj, mos u shqetësoni!

Po të them edhe një gjë tjetër, si i ri që je! Mos prit një shoqëri sterile! Matu me objektivat, jo me debatet e ditës! Debate ka pasur dhe do të ketë. Ato nuk ikin.

Zonja zëvendësministre, doni të bëni ndonjë plotësim?

Ardiana Jaku – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar bashkëpunëtorë të shoqërisë civile,

Ju falënderoj, që merrni vazhdimisht nisma dhe na sillni në vëmendje rëndësinë e kauzave tuaja!

Unë jam në rolin e dëgjueses sot. Gjithsesi, sjell angazhimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që çdo propozim që do të vijë nga ju, pa diskutim, do të shqyrtohet nga ana legjislative dhe nga ana financiare me të gjitha mekanizmat që kemi në dispozicion për t'u pasqyruar. Padyshim, duke konsideruar edhe ato raste, ku nuk do të ketë mbivendosje me legjislacionin në fuqi.

Ne sot po diskutojmë dhe po paraqesim një ligj që është miratuar në vitin 1996 dhe detyrimisht, pas kaq viteve, personalisht gjykoj se ka nevojë për ndryshime.

Nga ana tjetër, më lejoni t'ju them shumë shkurt edhe nismat ligjore që janë marrë së fundi, sa u takon ndryshimeve ligjore që prekin edhe këtë target-grup, siç është ligji nr. 18/2017 për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ku adresohen shumë qartë mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, ku përfshihet edhe kategoria e jetimëve gjithmonë me fokus mbrojtjen dhe interesin më të lartë të fëmijëve.

Nga ana tjetër, është edhe ligji nr. 121 që ka kaluar në vitin 2016 për shërbimet shoqërore në RSH. Edhe ky është një ligj i dedikuar shërbimeve shoqërore. Për t'i kthyer përgjigje edhe profesoreshë Muazezit, që standardet e shërbimeve shoqërore që ofrohen në institucionet e përkujdesit, i ka detyrim ligjor Shërbimi Social Shtetëror me 12 degët e tij në 12 qarqet e vendit që t'i monitorojë dhe padyshim, edhe t'i raportojë ato.

Unë i mbajta shënim dhe jam në pritje të propozimeve konkrete që do të sjellin organizatat e shoqërisë civile, që punojnë.

Më lejoni t'ju them se ligji për strehimin social është një ligj, i cili po punohet dhe po plotësohet me VKM. Pa diskutim, ju keni qenë pjesë e të gjitha dëgjësave dhe konsultimeve. Jetimët janë një nga kategoritë përfituese nga ky ligj, si edhe minoritetet, gjithashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, sepse bazohen në legjislacionin në fuqi, në statusin e jetimit, që është ligji në fuqi, që emi hapur diskutimin sot për ta riparë. Kështu, pa diskutim, që aty bazohem.

Për sa u takon shërbimeve për jetimët, më lejoni t'ju them se më 13 maj ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka lançuar planin e deinstitutionalizimit, i cili është një plan që e kemi në fokus, që na çon drejt shërbimeve të standardizuara, siç e përmenda dhe më sipër, në interesin më të lartë të fëmijës. Ne besojmë se duke u rritur fëmija në një ambient familjar, rritet në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne po marrim hapa konkretë që të shkojmë drejt këtij shërbimi, pra drejt shërbimit në familje dhe jo institutionalizimin e fëmijëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë marrë hapa konkretë dhe në bisedat që mund të kemi më pas, Ilir, do t'ju paraqes edhe se cili është plani. Atë e ka paraqitur ministrja më datë 30 dhe pa diskutim, unë jam shumë e gatshme ta diskutojmë hap pas hapi këtë plan.

Shumë faleminderit!

Jam shumë e gatshme për të diskutuar bashkërisht çështjet që i takojnë kësaj nisme.

Petrit Vasili - Faleminderit, zonja zëvendësministre, për praninë tuaj dhe për shpjegimet që na dhatë!

Ajo që ju thatë është e vërtetë, sepse sot në mbledhjen e komisionit fjalën e kishte shoqëria civile dhe besoj se të gjitha propozimet në detaje ishin mjaft të mira, prandaj mendoj se do ta lehtësojnë shumë punën për hartimin e një statusi të ri. Praktikisht me këto ndryshime do të kemi një status, i cili do të ndryshojë gjërat themelore dhe jam mëse i bindur se edhe gjatë hartimit të statusit ministria do të ketë një bashkëpunim me të gjithë këta zonja dhe zotërinj të pranishëm në këtë dëgjese. Arsyeja pse ne jemi të gjithë bashkë, parlamenti, përfaqësuesit e ministrisë dhe të gjitha shoqatat është pikërisht që të fitojmë kohën e humbur.

Ilir, jam dakord me ty që thua 27 vjet, por këta 27 vjet kanë ikur dhe ne jemi këtu për të mos humbur më...

(Diskutime pa mikrofon)

Kush qan për të shkuarën...

Kush e ka kokën nga pas vetëm përplasat me atë që ka përpara dhe nuk bën përpara.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush qan për shkuarën...

Nga sot e prapa të gjithë do të dalim me një impenjim të ri. Ne këtë gjë nuk do ta lëmë, në kuptimin e mirë të fjalës, sepse të gjitha propozimet do të bëhen dhe do t'i kërkojmë informacion sistematik me shkrim ministrisë se deri ku ka shkuar. Propozimi ynë miqësor do të ishte që menjëherë pas dëgjesës një grup i përbashkët i ministrisë të fillonte punën, ndërkohë që materialet do të vijnë, për t'i dhënë kohë vetes, sepse do të duhet kohë për të bërë një punë

të mirë, sepse po të donit ta bënit për 24 orë, personalisht do t'ju thosha se për kaq kohë nuk do të arrinit të bënit një punë të mirë. Pra, do t'ju duhet kohë, mendoj se deri në sezonin e shtatorit, meqenëse ngarkesa në verë bie, në mes të tetorit të kishim një draft të përmirësuar, i cili besoj se do të kishte një konsensualitet të plotë dhe të përdorshëm. Kjo do të thotë se në krye të disa muajve ne mund të bëjmë një punë, e cila nuk është bërë për vite me radhë. Pra, gjithë çelësi i gjësë është të mos humbasim më kohë, prandaj nga kjo pikëpamje mendoj që edhe puna e shoqatave ka qenë jo thjesht dhe vetëm sensibilitet emocional, por ka qenë profesionale, sepse në ndryshimet që janë propozuar ka një punë të mirëfilltë profesionale edhe në planin juridik, prandaj shumë prej tyre mund të akomodohen pa vështirësi të mëdha. Në rast se nuk ka ndonjë ndërhyrje, apo dikush prej jush ka ndonjë merak... Endrit, të lutem, në mënyrë të përmbledhur, të mos biem në përsëritje!

Endrit Reka – Jam plotësisht i vetëdijshëm për seriozitetin e kësaj seance dëgjimore dhe jo tryeze.

Zoti kryetar, ju bëj me dije se unë nuk jam jetim!

Ju bëj me dije se unë nuk kam shoqatë jetimësh!

Ju bëj me dije se nuk jam anëtar i asnjë partie politike!

Kur unë kam parë punën e këtyre 17 shoqatave të listuara në dokumentet që janë në dispozicionin tuaj, jam mahnitur.

Është e thjeshtë të bësh nihilistin dhe të mohosh punën e të tjerëve dhe t'i fusësh të gjithë në një thes, por faktet janë kokëforta, kush dëshiron t'i shohë...

Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj këto shoqata për punën që ato kanë bërë, 17 shoqatat që janë në listë, ndërsa për të tjerat... Faleminderit!

Petrit Vasili – A ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar? O na pajton të gjithëve ti, ose...

Gjin Marku – Ju e bëni më mirë detyrën e misionarit të pajtimit.

Ju pjesa politike e keni shumë më mirë detyrën e misionarit të pajtimit se sa ne në çdo rast kur e doni atë me të vërtetë.

Ju falënderoj në këtë drejtim për sa i përket pozicionit tuaj, edhe në këndvështrimin e debateve që mund të lindin në këtë drejtim!

Kam vetëm dy gjëra parasysh për komisionin në të ardhmen, sepse nuk e di nëse do të jem apo jo, në lidhje me dinjitetin e jetimit që të shihet, jo në këndin e mëshirës. Gjithashtu, nuk jam dakord me propozimin e Fredit për 30 vjet...

(Diskutime pa mikrofon)

Deri në 30 vjet është shumë, sepse duket sikur pastaj i nxjerrim jashtë dinjitetit dhe personalitetit jetimët, që të përballen me jetën, sepse ata kanë nevojë të edukohen që në fillim, sepse ata janë të zotët e vetes.

(Diskutime pa mikrofon)

Petrit Vasili – Nuk ka ndonjë gjë, sepse propozim alternativ është.

Gjin Marku – Pra, këtu duhet pasur kujdes te kjo pjesë, pasi kam përshtypjen se cenohet personaliteti po të çohet deri në 30 vjet, edhe po të jetë 25 vjet prapë shumë janë...

Petrit Vasili – A mund t'ju garantoj diçka?

Gjin Marku – Mbaron shkollën në moshën 25-vjeçare dhe në 30 vjeç iku...

Petrit Vasili – Më falni, ky është një diskutim, të cilin ne do ta rimarrim së bashku kur të kemi një draft dhe më pas secili të shpreh opinionin e tij, e mbështet ose jo. Ne hodhëm idetë themelore pse duhet të ndryshojë. E para.

E dyta, nevoja absolute për të ecur shpejt dhe për t'i ndryshuar gjërat shpejt. Kohë nuk kemi më për të humbur, kemi mësim të mira nga e shkuara, por kemi edhe mësim negative, të tëra do të vihen në tavolinë dhe gjëja më e rëndësishme është të mos i përsërisim më ato që na kanë rezultuar negative, kjo është një analizë gjakftohte dhe kush i shmanget kësaj analize nuk bën më legjislacion, por vetëm qep një legjislacion siç e do vetë.

Pra, mendoj se 25 apo 27 vjet dalin dhe teprojnë për të evidentuar se ne u nisëm nga vullneti i mirë, por kjo nuk rezultoi një masë efektive dhe nuk kemi pse ta përsërisim më në ligj, duke e larguar dhe duke futur elemente të tjera në ligj. Për mua elementet thelbësore janë elementet shpirtërore, sepse një jetim ka nevojë në momentin e formimit në fillimet e jetës së tij, më shumë se kurrë për atë që quhet ngrohtësi shpirtërore.

Në moshën 30 apo 40 vjeç jeta e ka bërë punën e saj, mund ta ketë konsoliduar apo ta ketë rrëzuar keq në tokë, por atëherë është shumë vonë. Si t'ia bëjmë për këtë moment? Të gjithë ne, edhe njerëzit e dinë, jam duke folur thjesht fare, edhe jojetimet mund të kemi qarë për një lodër që nuk na e ka blerë babai ose nëna në një moment të caktuar, apo për një dëshirë që nuk e kemi realizuar. Pra, në këtë plan duhet të fusim disa elemente të reja të ligjit që shoqëria të jetë gjithmonë e më solidare, por të jenë edhe disa mekanizma jo thjesht detyrues, por që e sensibilizojnë atë dhe e vënë në lëvizje.

Ne sot kemi perceptuar disa elemente thelbësore, qoftë elementet e mënyrës së menaxhimit financiar, sepse duhet një model menaxhimi krejtësisht i ri edhe për organizatat e shoqërisë civile, që të jenë efektive për çdo lek që hidhet. Nuk mund të pranohet dot premisa që paratë që hidhen për jetimet të shpërdorohen, sepse ky do të ishte mëkati më i madh që mund të ekzistonte, gjynah te Perëndia.

Prandaj, do t'ju sugjeroja që sot të mos qëndronim tek asnjë nga këto elemente, sepse të gjitha do të jenë drafte të papërpunuara, pasi propozimet, siç do të na vijnë, kemi për t'ia përcjellë të gjitha ministrisë dhe ne nuk kemi pse të bëjmë një përmbledhje, sepse janë

propozimet tuaja integrale dhe kjo gjë do t'i interesojë grupit të punës dhe më tutje do të punojmë së bashku.

Në fillim të shtatorit, në qoftë se na duhet të bëjmë një dëgjuesë paraprake në ndihmë të draftligjit e bëjmë me një mirëkuptim të plotë, siç e bëmë edhe sot. Unë mendoj që diskutimin ta lëmë këtu, sepse sot kemi filluar rrugën e një komunikimi të ri dhe në çdo rast që ju do të kërkon, duke parë edhe ecurinë e gjërave, ne do të na keni këtu, në mbështetje të plotë.

Faleminderit të gjithëve kolegëve që ishin të pranishëm!

MBYLLET MBLEDHJA